



# UDHËRRËFYES

## Politikat dhe Programet për pjesëmarrjen e të Rinjve në Tematikat e Trashëgimisë Kulturore

Ky publikim është prodhuar nga Qendra Trajnim Edukim Demokraci – TED në kuadër të programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës TED dhe nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS

Përgatitur nga: **Elsa Ballauri**

Asistuar nga: **Arian Polena**



## Përmbajtja

Qëllimi i Udhërrëfyesit .....	3
Metodologjia .....	4
Trashëgimia Kulturore dhe politikat kombëtare për përfshirjen e të rinjve .....	4
Rinia .....	10
Një analizë e situatës dhe faktorëve që ndikojnë në trashëgiminë kulturore .....	16
Rëndësia dhe roli i të rinjve në trashëgiminë kulturore .....	22
Rezultatet e pyetësorit .....	31
Konkluzione dhe rekomandime .....	45
Referenca të tjera.....	49



Funded by  
the European Union



## Qëllimi i Udhërrëfyesit

Ky udhërrëfyes përgatitet në kuadër të projektit “*Rinia Shqiptare - E ardhmja e Trashëgimisë Kulturore*” i cili ka në fokus “rritjen dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për rolin e trashëgimisë kulturore si një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik”, nëpërmjet :

- Inkurajimit për pjesëmarrjen aktive të të rinjve, të dëgjohet zëri i tyre se si ata mund të përfshihen dhe të kontribuojnë në trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen e saj;
- Mbështetjes për ruajtjen e artefakteve në qytetin e Durrësit si dhe identifikimin dhe katalogimin e artefakteve.

Projekti zbatohet nga “Qendra TED” e cila është një organizatë që synon rritjen e kontributit të qytetarëve në vendimmarrje dhe kulturë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, angazhimit qytetar, advokimit dhe kërkim-studimit.

Udhërrëfyesi ka si qëllim analizimin e situatës së angazhimit të të rinjve në trashëgiminë kulturore dhe synon ndërgjegjësimin e të rinjve, palëve të interesuara por edhe politikëbërësve për rëndësinë e përfshirjes së rinisë në trashëgiminë kulturore si një motor i fuqishëm zhvillimit socio-ekonomik të vendit tonë nëpërmjet turizmit kulturor.

Në udhërrëfyes paraqitet një analizë gjithëpërfshirëse e nevojës së ndërhyrjeve në sektor duke marrë në konsideratë sfidat dhe mundësitë që ekzistojnë për përmirësimin e mundësive të rritjes së përfshirjes së të rinjve në çështjet e trashëgimisë kulturore. Synohet të paraqiten disa rekomandime për rritjen dhe angazhimin e të rinjve por edhe të propozohen politika apo ndërhyrje që mbështesin dhe i japin përparësi pjesëmarrjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore dhe kulturë, duke marrë parasysh njëkohësisht kontekstet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Sigurimi i harmonizimit të strategjive për zhvillimin e të rinjve me strategjitë ekzistuese të ruajtjes së trashëgimisë kulturore konsiderohet të jetë thelbësore në këtë drejtim.

Bazuar në analizimin e politikave dhe strategjive ekzistuese por edhe përgjigjet e mbledhura nga të rinjtë e angazhuar në plotësimin e pyetësorit të përgatitur enkas për këtë qëllim do të lëshohen rekomandime të cilat do t’ju vihen në dispozicion autoriteteve përgjegjëse në nivel lokal (më tej edhe qendror) për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe atyre që kanë në fokus të tyre arsimin dhe zhvillimin e të rinjve.

Nisur nga kjo, qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe analizojë rolin e të rinjve në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në zonën e qytetit të Durrësit. Për këtë arsye u përgatit edhe një pyetësor i cili synon të anketojë dhe analizojë situatën e të rinjve në lidhje me ndërgjegjësimin e tyre kulturor dhe nivelin e tyre të përkushtimit dhe vullnetit për t’u angazhuar në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Pyetësori u shpërnda në disa shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Durrësit, i cili është një qytet mjaft i pasur me trashëgimi kulturore dhe i frekuentuar nga vizitorë vendas dhe turistë të huaj. Pyetësori u plotësua online nga rreth 100 të rinj, nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.



Funded by  
the European Union



Duke pasur parasysh faktin se ky vend është tashmë një destinacion turistik në zhvillim, ky studim mund të shërbejë si një mjet për politikëbërësit vendas për të iniciuar programe edukimi dhe ndërgjegjësimi, si dhe për të nxitur angazhimin e të rinjve në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ndërgjegjësimin e tyre dhe vlerave të saj për zhvillimin e turizmit.

Duke ndjekur këtë udhërrëfyes, politikëbërësit, organizatat kulturore dhe komunitetet mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm që fuqizon të rinjtë të marrin pjesë aktive në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore, duke siguruar vitalitetin e saj për brezat e ardhshëm.

## Metodologjia

Metoda e shfrytëzuar në përgatitjen e këtij dokumenti lidhet me studimin dhe zbatimin në praktikë të legjislacionit kombëtar për rininë dhe përfshirjen e saj në trashëgiminë kulturore ku ndër të tjera është marrë parasysh analiza e treguesve nga këndvështrimi i menaxhimit administrativ. Gjithashtu, në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë dokumenta dhe iniciativa të rëndësishme strategjike/financiare të Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Një burim i rëndësishëm informacioni kanë qënë edhe statistikat zyrtare të INSTAT të cilat kanë qënë thelbësore për krijimin e një pasqyre statistikore në analizat e këtij dokumenti. Punimi është shoqëruar me analiza kritike dhe krahasimore, duke marrë në konsideratë çështje të cilat lidhen me përfshirjen e rinisë në kulturë dhe trashëgiminë kulturore. Një vlerë e shtuar në këtë dokument është pyetëtori (shoqëruar me analizë dhe grafikë) i shpërndarë për të rinjtë i cili synon të evidentojë njohuritë dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe efektet pozitive që ajo sjell në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Duke marrë në analizë sa më sipër, në dokument propozohen masa konkrete të cilat mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm që ju mundëson të rinjve të marrin pjesë aktive në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

## Trashëgimia Kulturore dhe politikat kombëtare për përfshirjen e të rinjve

Trashëgimia kulturore mund të përkufizohet si trashëgimi e artefakteve fizike (pronësi kulturore) dhe atributëve jomateriale të një grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara. Trashëgimia kulturore është një koncept që ofron një urë lidhëse midis së shkuarës dhe së ardhmes me aplikimin e qasjeve të veçanta në të tashmen. Në përputhje me përfundimin e UNESCO-s<sup>1</sup>, trashëgimia kulturore përfshin artefakte, monumente, një grup ndërtesash dhe *sajtesh* arkeologjike, muzetë që kanë një larmi vlerash duke përfshirë rëndësinë simbolike, historike, artistike, estetike, etnologjike ose antropologjike, shkencore dhe sociale. Ajo përfshin

<sup>1</sup> <https://uis.unesco.org/en/glossary-term/cultural-heritage>



Funded by  
the European Union



trashëgiminë e prekshme (të luajtshme, të palëvizshme dhe nënujore), trashëgiminë kulturore jomateriale të shprehur në artefakte, zona ose monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Ndër shekuj, populli shqiptar ka krijuar një pasuri kulturore materiale dhe jo materiale mjaft të pasur, e cila mund të krahasohet lehtësisht me atë të popujve dhe kombeve më të vjetra të Evropës. Në rrjedhën e historisë, territori i sotshëm i Republikës së Shqipërisë, i ndodhur në udhëkryqet e Evropës, Ballkanit e Mesdheut ka përjetuar shumë pushtime dhe luftëra që kanë vënë në rrezik identitetin kulturor të shqiptarëve. Mes kulturash dhe qytetërimesh, krahas kulturës shqiptare, gjenden shtresëzime të kulturës pararendëse ilire apo të kulturave të tjera, si: kultura greke, romake, venedikase, osmane dhe kultura të vendeve ballkanike. Ka qenë pikërisht kultura, ajo që ka bërë që shqiptarët, pavarësisht këtyre peripecive historike, të ruajnë identitetin e tyre kombëtar.

Shqipëria ka aderuar dhe ratifikuar konventa të ndryshme ndërkombëtare dhe konventa evropiane për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale. Këto përfshijnë Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore<sup>2</sup> (1989), Konventën për Mjetet e Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore (2002), Konventës për Mbrojtjen e të Paprekshmes Trashëgimia Kulturore (2006), Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore (2006) dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike (2007). Vendi është shumë i pasur me prona të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Katër nga këto prona janë të regjistruara në listën e Trashëgimisë Botërore, si pasuritë kulturore të Zonës Arkeologjike të Butrintit (1992) dhe Qendrat Historike të Gjirokastrës dhe Beratit (2005, 2008). Shqipëria është gjithashtu pjesë e pronës natyrore të pyllit të lashtë dhe parësor të ahut të Karpateve dhe rajoneve të tjera të Evropës (2007) dhe liqenit të Ohrit (pjesa shqiptare) si pjesë e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit në 2019.

Për sa i përket trashëgimisë jomateriale, Isopolifonia Popullore Shqiptare është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Botërore në vitin 2005.

Ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore në Shqipëri funksionojnë në bazë të ligjit nr. 27, dt. 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe dispozita të tjera ligjore dhe nënligjore, programe apo strategji që lidhen me të. Ministria e Kulturës dhe disa institucione të specializuara në varësi të saj janë të angazhuara në menaxhimin dhe shfrytëzimin e vendeve të trashëgimisë kulturore për zhvillimin e turizmit.

Në fokus të këtij studimi është Durrësi i cili është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri dhe është njëkohësisht edhe qendra e prefekturës dhe qarkut të Durrësit. Në rang qarku, Durrësi renditet në vendin e dytë për nga numri i popullsisë me një peshë prej 10,5 % të popullsisë totale të vendit

---

<sup>2</sup><https://www.kultura.gov.al/konventa-nderkombetare-te-ratifikuar-nga-republika-e-shqiperise-per-trashegimine-kulturore/>



Funded by  
the European Union



UNOPS



tonë ose 289,797 banorë<sup>3</sup>. Durrësi është një nga qytetet më të lashta dhe më të rëndësishme ekonomike të Shqipërisë.

Historia e Durrësit mund të krahasohet me qytetet më të mëdha antike të Mesdheut; gjurmët e të cilit datojnë që në shekujt XII-XI përpara Krishtit. Bazuar në të dhënat e faqes zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, rezulton që Qarku i Durrësit ka të regjistruar një numër prej 67 monumentesh kulture dhe zona të mbrojtura<sup>4</sup>, nga të cilat 36 prej tyre rezultojnë të jenë brenda territorit të Bashkisë Durrës. Disa prej tyre janë klasifikuar si monumente kulture të kategorisë së parë. Disa prej monumenteve më të rëndësishëm që tërheqin më shumë vizitorë paraqiten më poshtë.

- ✚ Muret rrethuese të Durrësit - rëndësia e këtyre mureve të Kalasë së Durrësit është themelore për qytetin, pasi ato janë të vjetra sa vetë qyteti i Durrësit. Pamjen e tyre më madhështore, muret rrethuese të Durrësit e morën gjatë antikitetit të vonë, në periudhën e Perandorit të Bizantit, Anastas (491 -518), i cili ishte me origjinë nga Durrësi.
- ✚ Amfiteatri i Durrësit, më i madhi dhe më i rëndësishmi, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan, është ndërtuar në fillim të shek të II të e.s gjatë sundimit të perandorit Trajan. Ai ka vlera të veçanta arkitekturore dhe artistike dhe mund të krahasohet me monumentet e kësaj periudhe të Pompeit dhe Kapuas në Itali. Amfiteatri ka trajtë elipsi me diametër 136 metra dhe lartësi rreth 20 m. Kapaciteti ishte për rreth 16.000-20.000 veta, ndërsa në arenë zhvilloheshin luftimet e gladiatorëve.
- ✚ Muzeu Arkeologjik - muzeu është përruruar më 13 prill 2002, mbi bazën e materialeve të Muzeut të parë arkeologjik, i hapur më 13 mars 1951. Ekspozita është organizuar në tre pavione sipas periudhave historike. Salla e parë fillon me vitrinën e gjetjeve prehistorike në qytet e rreth. Në rend kronologjik ndiqet pandërprerje historia e qytetit në periudhën arkaike, klasike dhe qytetare ilire deri në shek.I p.e.re. Termeti me magnitudë 6,3 i shkallës Rihter i vitit 2019 dëmtoi rëndë Muzeun Arkeologjik të Durrësit dhe duke qënë një objekt i rëndësishëm kulturor dhe historik, ky muze u përzgjedh për t'u restauruar në kuadër të programit “EU4Culture”, financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë
- ✚ Torra Veneciane: Kulla rrethore (Torra), u ndërtua në shek. XV mbi kullën bizantine. Kjo dëshmohe nga prania e blloqeve nga rrethoja e mëparshme, e fragmenteve arkitektonike dhe e relieveve antike. Kulla ka diametrin 16 m dhe lartësinë 9 m. Edhe Torra Veneciane, si shumë objekte të tjera kulturore dhe historike të qytetit të Durrësit, pësoi dëmtime nga

<sup>3</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>

<sup>4</sup> <https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet--Qarku-Durres.pdf>



Funded by  
the European Union



tërmeti i vitit 2019. Me mbështetjen e Programit EU4Culture gjatë vitit 2022 u financuan edhe ndërhyrjet për restaurimin e këtij objekti duke e kthyer atë në një qender interpretimi digjtal të trashëgimisë kulturore.

- ✚ Banka e Shtetit Shqiptar: banka e shtetit në Durrës u ndërtua më 10 nëntor 1928. Themelet e saj janë mbi kullën juglindore të rrethojës bizantine, e quajtur “Bastioni i madh”. Ndërtesa është projektuar nga arkitektë italianë dhe realizuar nga mjeshtrat durrsakë. Nga ana kompozicionale hyn në veprat e stilit barok, që përdoret për herë të parë në vendin tonë.

Megjithatë, disa nga objektet e vjetra të trashëgimisë vuajnë mungesën e investimeve dhe rrezikojnë të humbasin vlerat e tyre për shkak të shkatërrimit. Gjithashtu, në disa prej monumenteve siç janë muzeu etnografik, muret e kalasë (kulla C) ende ndihen dëmet e shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019.

Qyteti ruan sot plot gjurmë edhe nga kultura më e vonë, duke kontribuar edhe në dhënien e personaliteteve me vlerë ndërkombëtare si Aleksandër Moisiu, që lindi në Kavajë dhe u rrit e u formua në Durrës. Qyteti ka patur institucione kulturore të konsoliduara, si teatër estrade, ansambël këngësh e vallesh popullore, teatër profesionist, i cili edhe sot jep shfaqje për publikun, trup muzikore profesionistësh etj. Gjithashtu në Durrës organizohen aktivitete në rang kombëtar e ndërkombëtar si, festivali ndërkombëtar i filmit, festivali muzikor i jazz-it, konkursi i poezisë “Poeteka”, etj. Gjithashtu, Durrësi ka edhe një pasuri nënujore, e cila përbën një vlerë të e cila mund të inkurajojë akoma më shumë zhvillimin e turizmit arkeologjik.

Durrësi është destinacioni më i madh turistik në vendin tonë, ndryshe Durrësi njihet dhe si kryeqyteti i turizmit në Shqipëri. Sipas të dhënave zyrtare të Bashkisë Durrës, vetëm vitin e kaluar mbi 1 milion turistë nga Italia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Franca, Gjermania, Anglia, Austria, Belgjika, Bullgaria, Rumania, etj kanë qëndruar mesatarisht 5-7 ditë në qytet.

Edhe pse kjo shifër mund të konsiderohet tejet optimiste dhe nuk mund të konfirmohet nga INSTAT pasi ky institucion nuk disponon të dhëna zyrtare të ndara sipas qyteteve, qëndrimi i turistëve në këtë qytet ndodh gjatë verës dhe lidhet kryesisht me plazhin që bregdeti i Durrësit ofron, veçanërisht për pushuesit nga Kosova dhe Polonia. Sipas të dhënave të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, gjatë muajit korrik 2022, Muzeu Arkeologjik dhe Amfiteatri i Durrësit u vizitua nga 4391 vizitorë, shifër që tregon kjo për interesin jashtëzakonisht të ulët të turistëve që kanë vizituar këtë qytet. Sipas Ministrisë së Kulturës, për vitin 2022 ka pasur një rritje prej rreth 38% të vizitorëve në krahasim me vitin 2021<sup>5</sup>.

Megjithatë, për arsye të numrit të konsiderueshëm të monumenteve dhe afërsisë ndërmjet tyre, sipas të njëjtit burim, vitet e fundit vihet re një rritje e turizmit kulturor në qytet. Sipas

<sup>5</sup> <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/BULETINI-I-TURIZMIT-DHJETOR-2022.pdf>



Funded by  
the European Union



raportimeve të Ministrisë së Turizmit<sup>6</sup>, vetëm gjatë muajit gusht 2023 që është edhe piku i sezonit turistik, institucionet kulturore në nivel kombëtar janë vizituar nga 185,305 vizitorë. Gjatë këtij muaji rezultoi të ketë pasur një rritje prej 34 % krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2022. Nga objektet kulturore në qytetin e Durrësit, vendin e parë për këtë qark dhe vendin e dytë në nivel kombëtar në kategorinë e kalave e mban Amfiteatri i Durrësit me 18,300 vizitorë gjatë muajit Gusht 2023.

Qyteti i Durrësit ka asete të rëndësishme kulturore, historike dhe arkeologjike të cilat janë bazat për të pasur një ofertë të pasur turistike gjatë gjithë vitit. Durrësi ka një potencial mjaft të madh për turizmin që lidhet me trashëgiminë kulturore por fatkeqësisht, jo shumë pika arkeologjike/kulturore janë valorizuar dhe ruajtur me elementët e tyre artitekturorë.

Në praktikë dhe jo vetëm në rastin e qytetit të Durrësit, trashëgimia kulturore akoma nuk është njohur si një faktor kryesor për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në këtë rajon. Mungesa e fondeve nga qeveria dhe bashkia, mungesa e njohurive dhe burimeve njerëzore të institucioneve qëndrore dhe bashkisë, aktiviteti i ulët i konservimit, promovimi i pamjaftueshëm i trashëgimisë kulturore, mungesa e një oferte kulturore strategjike, mungesa e projekteve inovative për valorizimin e ndërtesave me rëndësi kulturore janë disa nga arsyt kryesore që qyteti nuk e ka arritur ende potencialin e tij turistik. Siç theksohet edhe më sipër, Durrësi ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit dhe sektoreve tjerë mbeshtetës nëpërmjet kombinimit të turizmit bregdetar me atë kulturor dhe arkeologjik. Nje kombinim i tillë do ta shtrinte aktivitetin turistik përgjatë gjithë vitit dhe do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e të ardhurave nga turizmi dhe në zhvillimin ekonomik e social të qarkut. Si rezultat i mungesës së infrastrukturës/logjistikës dhe politikave lokale të pamjaftueshme, duket se mungon informacioni që lidhet me pasqyrimin, vizibilitetin dhe promovimin e vlerave dhe objekteve kulturore të Durrësit.

Në nivel lokal, edhe pse në faqen zyrtare të bashkisë ka informacion të detajuar mbi pikat turistike kryesore dhe sitet e trashëgimisë kulturore, të dhënat e lidhura me angazhimin e të rinjve në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore janë shumë të kufizuara.

Në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet kryesore mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë. Konkretisht këto detyrime evidentohen në:

- i. *Nenin 3*, ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, ku ndër të tjerash kërkohet që realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e antarëve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

---

<sup>6</sup> <https://www.monitor.al/turizmi-kulturor-vizitoret-u-rriten-me-45-kryeson-muzeu-i-krujes-dhe-kalaja-e-gjirokastres/>





Funded by  
the European Union



- ii. *Nenin 16*, ku specifikohet se organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.
- iii. *Nenin 23*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e 3 infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, kulturës etj);
- iv. *Nenin 25*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- v. *Nenin 28*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- vi. *Nenin 29*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike. Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Për më tepër, ligji 75/2019 “Për rininë”, si një ligj bazë për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, kërkon nga organet lokale krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve

Në këtë drejtim Bashkia Durrës është një ndër bashkitë e vendit, që ka investuar dhe është angazhuar ndër vite për çështjet rinore. Kjo bashki ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale si dhe me organizata jo-fitimprurëse për iniciativat rinore. Bashkia Durrës ka miratuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë 2020-2023<sup>7</sup>, si një dokument kryesor politik që adreson çështjet rinore në nivel lokal. Ky dokument është realizuar në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert. Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023, ndër të tjerash parashikon dhe adresimin e çështjeve të lidhura me artin, sportin kulturën dhe mbjedisin. Fatkeqsisht mungojn të dhëna mbi mbi zbatimin konkret të këtij plani.

Një element pozitiv që duhet të përmendet është krijimi i Këshillit Rinor Vendor Durrës. Ky Këshill ka për qëllim përkrahjen, konsulencën, aktivizimin, vullnetarizmin dhe zhvillimin e lidërshiptit për rininë e qytetit. Detyrat kryesore të Këshillit Rinor Vendor Durrës janë:

- Ti propozojë Këshillit Bashkiak përisimin e politikave vendore si dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në territor;
- Ndjekja dhe zhvillimi i veprimtarive rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë.

<sup>7</sup> [https://tirana.fes.de/fileadmin/user\\_upload/documents/Plani\\_lokal\\_i\\_veprimit\\_per\\_rinine\\_2020-2023\\_Durres.pdf](https://tirana.fes.de/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Durres.pdf)



Funded by  
the European Union



Edhe pse Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023, si dhe rregullorja e Këshillit Rinor Vendor përmbajnë shumë elemente për angazhimin e të rinjve në aktivitete dhe politika konkrete të lidhura, ndër të tjera, dhe me trashëgiminë kulturore, aktualisht nuk ka të dhëna mbi realizimin faktik të këtyre planeve dhe prioriteteve, si rrjedhojë për përgatitjen e këtij dokumenti jemi bazuar gjërësisht në të dhënat e ofruara nga organet publike qëndore.

## Rinia

Për qëllime statistikore, Organizata e Kombeve të Bashkuar e përkufizon “rininë” si ata persona midis moshës 15 dhe 24 vjeç, por nuk ka një përkufizim universal. Meqenëse përvoja e të qenit i ri mund të ndryshojë ndjeshëm në të gjithë botën, midis vendeve dhe rajoneve, “rinia” konsiderohet si një kategori fleksibël. Sipas Raportit Botëror të Rinisë (2020), ka 1.2 miliardë të rinj të moshës 15 deri në 24 vjeç, të cilët përbëjnë 16 % të popullsisë globale<sup>8</sup>. Bazuar në shumë standarde dhe dokumente të Bashkimit Evropian dhe Këshillit Evropian të rinjtë konsiderohen ata persona, mosha e të cilëve varion nga 15 deri në 29 vjeç. Edhe në Shqipëri, sipas kuptimit të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, “të rinj” konsiderohen personat që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç.

Sipas raportit të vitit 2023 të INSTAT, Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me moshë relativisht të re, ku të rinjtë nga mosha 15 deri 29 vjeç përbëjnë 21,28% të popullsisë së përgjithshme të vendit tonë (587.888 të rinj)<sup>9</sup>.

Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2022<sup>10</sup>, në arsimin 9-vjeçar (në ciklin e lartë të arsimit bazë) rezultojnë të regjistruar 123,998 nxënës, në arsimin e mesëm (i përgjithshëm dhe profesional) rezultojnë të regjistruar 103.467 nxënës, ndërsa në arsimin e lartë rezultojnë të jenë të regjistruar 123,880 studentë. Numri i përgjithshëm i personave të rinj (pa përfshirë ciklin fillor dhe kopshtet) që janë në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me procesin arsimor është 351.345 të rinj.

Në krahasim me vitin 2018, numri i studentëve të regjistruar në arsimin publik ka rënë me 19.7%, ose rreth 22.3 mijë studentë më pak<sup>11</sup>. Plakja graduale e popullsisë që ka ulur grupmoshën e re, së bashku me emigrimin e të rinjve vlerësohen si arsyt kryesore që kanë ndikuar në këtë tendencë. Universitetet e rretheve kanë parë rënien më të madhe të studentëve. Në pesë vjet Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka humbur më shumë sesa gjysmën e studentëve, duke shënuar vetëm rreth 3.7 mijë të regjistruar në vitin akademik 2022/2023, nga 8245 në 2016-n. Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kishte 37% më pak studentë në 2022-n, në raport me pesë vjet më parë, në atë të “Fan S.Noli” Korçë dhe “Ismail Qemali” Vlorë, nga rreth 30% më pak.

<sup>8</sup> <https://www.un.org/development/desa/youth/wp-content/uploads/sites/21/2020/07/2020-World-Youth-Report-FULL-FINAL.pdf>

<sup>9</sup> <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB/>

<sup>10</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/>

<sup>11</sup> [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_ED\\_REG/ED0101/?rxid=2e23b513-ac38-4230-8e64-6216d994d43b](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_ED_REG/ED0101/?rxid=2e23b513-ac38-4230-8e64-6216d994d43b)



Funded by  
the European Union



Përrjashtim bën vetëm Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës i cili ka të njëjtin numër studentësh të regjistruar në raport me pesë vite më parë.

Rinia, si pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare vuan shkallën më të lartë të papunësisë nga të gjithë grupmoshat. Gjatë vitit 2023, sipas INSTAT, shkalla e papunësisë së të rinjve ishte 22,5%. Kjo përqindje është rreth dy herë më e lartë se niveli i papunësisë për të gjithë popullsinë e moshës 15 vjeç e lart<sup>12</sup>.

Duke u kthyer pas në kohë për të analizuar mbështetjen konkrete të qeverisë shqiptare ndaj të rinjve, i vetmi dokument gjithpërfshirës rezulton të jetë Plan i Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 383, dt. 06.05.2015.

Në letër, ky Plan duke qënë pjesë e Programit të Qeverisë për Rininë, i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, i Strategjisë së Bashkimit Europian për Rininë, si dhe Planit Kombëtar të Veprimit Për Zbatimin e Strategjisë Rajonale SEE (2014-2020) shënon një moment të rëndësishëm kthese në qasjen e politikës ndaj rinisë. Ideja e hartimit të Planit Kombëtar për Rininë erdhi si një domosdoshmëri në kushtet e atëhershme, jo vetëm nisur nga fakti i përfundimit të mandatit të strategjisë kombëtare së mëparshme të rinisë (2007-2013), por dhe si rezultat i nevojës për tu përpatur me ndryshimet social-ekonomike dhe kulturore në Shqipëri.

Për herë të parë u hartua një plan ndërsektorial për mbështetjen e rinisë ku u përfshinë 11 Ministri Linje ndërsa plani në objektivat e tij kryesore parashikonte edhe mbështetjen për angazhimin e të rinjve në kulturë, përfshirë edukimin, punësimin, shëndetësinë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Megjithatë, mbështetja që ofroi ky Plan për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore konsistonte vetëm në organizimin e disa aktiviteteve artistike dhe aktiviteteve ndërgjegjësuëse me të rinjtë mbi rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore si dhe prodhimi i materialeve informative me përshkrime mbi vlerat dhe trashëgiminë kulturore shqiptare.

Pavarësisht kësaj, u hodhën hapa të rëndësishëm në krijimin e institucioneve/strukturave alternative të cilat kishin në fokus së punës së tyre mbështetjen për rininë, siç ishte; ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë, si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave dhe programeve rinore të miratuara nga ish-Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë; ngritja e Qendrave Rajonale Rinore; ngritja e Qendrave “Shërbime Miqësore për të Rinjtë” në çdo Prefekturë; krijimi i Korpusit të Rinisë; Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe strukturat e qeverisjes vendore (Këshillat bashkiak dhe komunë). Sot këto struktura nuk ekzistojnë më ose janë riorganizuar në bazë të prioriteteve dhe qasjeve të qeverive pasardhëse.

Në vitin 2015 u ngrit “Rrjeti Kombëtar i Rinisë Shqiptare”, i cili është një rrjet rinor i përbërë nga forume politike dhe grupe rinore të shoqërisë civile në nivel lokal dhe kombëtar dhe

<sup>12</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/>



Funded by  
the European Union



promovon programe për të mbështetur të rinjtë dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. Pavarësisht përfshirjes së rrjetit në sferën politike, ekonomike dhe sociale, mbështetja për angazhimin e të rinjve në projekte dhe/ose aktivitete që synojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është përmendur shumë pak dhe mbetet në nivel të ulët. Megjithatë, falë angazhimit të kësaj organizate, sot pranë çdo Bashkie është ngritur dhe funksionon Bordi Rinor Këshillimor.

Në bazë të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” u përcaktua ngritja dhe funksionimi i një Ministrie të posaçme përgjegjëse për rininë si dhe ngritja e Këshillit Kombëtar të Rinisë që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë dhe ngritja e Këshillit Vendor të Rinisë që funksionon pranë kryetarit të çdo bashkie. Sot, ministria përgjegjëse për rininë është Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët e cila ka në varësi të saj Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Përveç institucioneve apo strukturave përgjegjëse për rininë dhe kulturën të cilat nuk kanë patur prioritet të punës së tyre lidhjen e rinisë me trashëgiminë kulturore, janë për tu përshëndetur disa iniciativa të Ministrive përgjegjëse për Kulturën, Turizmin dhe Arsimin të cilat kanë konsistuar në organizimin e programeve/projekteve të veçanta të cilat kanë pasur në fokus pjesëmarrjen e rinisë në aktivitete të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe promovimin e tyre në favor të zhvillimit të turizmit.

Programi “Edukimi Përmes Kulturës”<sup>13</sup> ka nisur të formësohet në vitin 2014, kur edhe janë iniciuar projektet e para edukative në bashkëpunim me institucionet kulturore në varësi të Ministrisë së Kulturës, kryesisht në Tiranë. Kjo formë e qasjes ndaj ngritjes së njohurive dhe vetëdijes së brezave për rëndësinë dhe përfitimin nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore ka hasur në interesim të madh të pjesëmarrësve të grupmoshave të ndryshme. Përmes këtij programi është synuar njohja e brezave të rinj me artin dhe trashëgiminë kulturore në Shqipëri dhe nxitja e dëshirës për të krijuar dhe çmuar pasuritë kulturore. Programi synon që institucionet arsimore dhe kulturore të ndihmojnë brezin e ri që të zhvillojë vetëbesimin, si individë dhe anëtarë të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë; të inkurajoj ata për të zhvilluar një gamë të gjerë të aftësive dhe interesave të tyre; të identifikoj dhe nxis potencialin e tyre si dhe të zhvilloj kreativitetin e tyre. Ai gjithashtu synon njohjen e vlerave të trashëgimisë materiale dhe jomateriale të vendit nëpërmjet projekteve të ndryshme brenda programit.

Nga fondi i thirrjeve për projekte 2014-2015 nga ana e Ministrisë së Kulturës janë mbështetur rreth 30% e projekteve me platformë artistike dhe kulturore me fokus edukimin përmes kulturës<sup>14</sup>. Gjatë vitit 2014, 9.677 nxënës të 107 shkollave të mesme dhe nëntëvjeçare janë përfshirë si organizatorë apo pjesëmarrës të veprimtarive përmes trashëgimisë kulturore, ndërsa në 2015, regjistrohen 12.054 nxënës në 147 shkolla. Gjatë vitit 2018 programi ka arritur përfshirjen e numrit rekord prej 55,000 nxënësish të moshave të ndryshme nga rreth 500 shkolla

<sup>13</sup> <https://www.kultura.gov.al/marrevshje-e-mk-dhe-mas-per-edukimin-permes-kultures/>

<sup>14</sup> <https://www.kultura.gov.al/marrevshje-e-mk-dhe-mas-per-edukimin-permes-kultures/>



Funded by  
the European Union



në gjithë vendin, me pjesëmarrje në rreth 700 aktivitete të organizuara nga institucionet kulturore të varësisë. Ndikimi pozitiv i zbatimit të këtij programi dëshmohet nga rritja prej 55% e numrit të vizitorëve në institucionet kulturore, përmes pjesëmarrjes në aktivitete kulturore dhe edukuese në këto institucione, tendencë e cila shihet me prioritet për zhvillim më të gjerë.

Ky program është realizuar në bashkëpunim të ngushtë mes Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë përmes Marrëveshjes së nënshkruar më 25.01.2016, dhe institucioneve të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore së bashku me institucionet arsimore të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Programi “Edukimi përmes Kulturës” është në përputhje të plotë me Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, e cila përfaqëson standardet kryesore ndërkombëtare të Politikave Kulturore në Evropë si dhe vjen në hamoni të plotë dhe me Deklaratën e Këshillit të Ministrave të Kulturës të Evropës Juglindore, dokument që nxjerr në pah rolin e rëndësishëm të kulturës dhe artit në fushën e arsimit, pasi edukimi përmes kulturës “nxit vetëdijen kulturore dhe shprehjes, krijimtarinë dhe diversitetin, si edhe kontribuon në zhvillimin njerëzor, social-kulturor në mirëqenien dhe kohezionin social.

Ky program është reflektuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025 dhe është pjesë e objektivit specifik 5 të kësaj strategjie – Edukimi përmes Kulturës.

Problematika e identifikuar gjatë zbatimit disa-vjeçar të programit është përqendrimi i aktiviteteve kryesisht në zonat urbane të vendit, e veçanërisht në qytetin e Tiranës, ku gjenden numri më i madh i institucioneve kulturore të varësisë. Programi i edukimit duhet të zgjerohet edhe te operatorët e pavarur përmes projekteve me thirrje me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve në vendet ku institucionet kulturore vendore dhe qendrore e kanë të vështirë të shtrijnë veprimtarinë e tyre.

Disa nga projektet kryesore të financuara nga ky program<sup>15</sup> paraqiten si më poshtë:

- *Projekti “Arkeologu i vogël”* synon që të afrojë në institucionet muzeore fëmijët e të gjithë vendit. Projekti ka si qëllim të bëjë pjesë të gërmimeve arkeologjike fëmijët, duke ju mësuar atyre përdorimin e mjeteve arkeologjike dhe teknikat e gërmimit dhe duke u dhënë mundësinë të jenë arkeologë për një ditë dhe të bëjnë zbulimet e tyre për epokat kryesore historike në Shqipëri. Nxënës të shkollës “Marie Kaçulini” në Durrës u bënë pjesë e një prej këtyre aktiviteteve edukative të Muzeut Historik Kombëtar.

- *Projekti “Miku i monumentit”* është një nga veprimtaritë më të rëndësishme, i cili konsiston në atë që është quajtur si “marrja e përgjegjësisë publike (mosdëmtimi i objekteve kulturore)” për njohjen dhe ruajtjen e monumenteve historike, përkujdesjen dhe realizimin e veprimtarive me karakter edukativ e kulturor, nga nxënësit e shkollave të qyteteve. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit i dorëzuan shkollave të cilat kanë pranë një monument

<sup>15</sup> <https://www.kultura.gov.al/edukimi-mbi-dhe-permes-kultures/>



Funded by  
the European Union



kulture, një certifikate birësimi të monumentit përkatës. Shkollat “Jan Kukulzeli” dhe “Gjergj Kastrioti” u bënë pjesë e këtij projekti në qytetin e Durrësit.

- *Projekti “Muzeu im”*, i organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar konsiston në mundësinë që ky Muze ofron për çdo qytetar (veçanërisht të rinjtë) për të ekspozuar objekte të vjetra të trashëguara nga të parët e tyre.

- *Projekti “Artizanati dhe brezi i ri”*, ka pasur si qëllim sensibilizimin e nxënësve mbi vlerat e peizazhit kulturor i cili në kohët e fundit është konsideruar një lloj i veçantë i Trashëgimisë Botërore, pasi është një pikë referimi më e hapur si një model morfologjik, funksional, shprehje perceptuar dhe simbolike e marrëdhënieve historike dhe aktuale midis shoqërisë dhe natyrës. Vlerat kulturore dhe natyrore janë cilësitë që e bëjnë një vend ose peizazh të rëndësishëm.

- *Projekti “Eja këndo me ne”* u zbatua nga Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit dhe kishte si qëllim njohjen e fëmijëve me elementët bazë të muzikës korale dhe folklorike. Në fazën finale u organizua një mbrëmje konkursi mes shkollave të Tiranës.

Ndërsa, gjatë periudhës 2018-2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit zbatoi Programin “Smile Albania”<sup>16</sup>, i cili angazhoi rreth 2000 të rinj gjatë gjithë sezonit turistik në të gjitha pikat kufitare dhe zonat turistike, për ta kthyer Shqipërinë në një destinacion turistik evropian. Programi u fokusua në ndërgjegjësimin e të rinjve dhe angazhimin e tyre për të promovuar natyrën e bukur, vendet e trashëgimisë kulturore dhe mikpritjen shqiptare për turistët e huaj. Nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga ky Program ku një vend të rëndësishëm patën trajnimet për trashëgiminë kulturore, u mundësua punësimi i rreth 1000 studentëve gjatë sezonit turistik.

Duke u kthyer pas në analizimin e politikave sektoriale për këtë çështje, rezulton se në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, nuk është marrë në konsideratë rëndësia e përfshirjes së trashëgimisë kulturore në arsimin parauniversitar. Megjithatë, edukimi për trashëgiminë kulturore është i përfshirë në kurrikulat e arsimit të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.

Në arsimin fillor, njohuritë e kulturës, traditave dhe zakoneve janë të integruara në lëndën “Edukimi për Shoqërinë”. Edukimi dhe ndërgjegjësimi për trashëgiminë kulturore forcohet nga lënda e “Historisë”, duke marrë njohuri për trashëgiminë e qytetërimeve të lashta. Përveç edukimit formal, historia mësohet edhe përmes edukimit joformal duke marrë pjesë në projekte jashtëshkollore dhe duke vizituar muze dhe vende të trashëgimisë kulturore.

Në arsimin e mesëm nxënësit zhvillojnë njohuritë e tyre të trashëgimisë në lëndët “Histori” dhe “Gjeografi”. Në lëndën e “Gjeografisë” së klasës së 9-të, nxënësit analizojnë ndërveprimin midis sistemeve fiziko-gjeografike, sociale dhe ekonomike të Shqipërisë dhe zonës përreth vendit. Një nga çështjet kryesore që trajtohet është Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Shqipërisë dhe zhvillimi i turizmit. Lidhur me trashëgiminë kulturore, nxënësit mësojnë të vlerësojnë dhe

<sup>16</sup> <https://turizmi.gov.al/smile-albania/>





Funded by  
the European Union



përshkruajnë sa vijon, përkatësisht: tiparet e përgjithshme të trashëgimisë kulturore, kategoritë e saj dhe shërbimet që lidhen me secilën prej këtyre veçorive nga pikëpamja e turistëve.

Shkollat organizojnë gjithashtu aktivitete që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore lokale dhe zhvillojnë konkurse artistike, të cilat nxisin aftësitë krijuese të nxënësve në prezantimin e vlerave kulturore. Në kurrikulën e shkollës së mesme, trashëgimia kulturore mbulohet më mirë në lëndën e “Gjeografisë”. Duke marrë në konsideratë gjeografinë rajonale të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, “Gjeografia” e klasës së 11-të u jep nxënësve njohuri mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore, vlerat dhe kategoritë e tyre.

Në Gjeografinë e klasës së 12-të (kjo është lëndë me zgjedhje), synohet që nxënësit të kuptojnë dhe vlerësojnë kulturat, stilin e jetës dhe zhvillimin e botës sipas vështrimit rajonal të popullsisë, kulturave dhe zhvillimeve ekonomike.

Megjithatë, njohuritë që nxënësit marrin deri në këtë nivel arsimor konsiderohen të pamjaftueshme për ndërgjegjësimin e këtyre grupmoshave të reja në kuadrin e trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjes së saj.

Në të vërtetë, në arsimimin e qytetarëve të tij, shteti hedh bazat e dijes dhe vetëvendosjes, pa të cilat tregjet nuk mund të funksionojnë. Është e nevojshme të theksohet se përfitimet nga politika kulturore kanë të bëjnë me sensibilizimin e qytetarëve për vlerat e pazëvendësueshme të aktivitetit krijues, jo vetëm në art, kulturë dhe trashëgimi, por në gjithë jetën shoqërore, duke i kushtuar kështu rëndësi të posaçme formimit të një sistemi edukativ kulturor në të gjitha nivelet shkollore. Në këtë drejtim, arsimi kulturor dhe edukimi në media janë pjesë e rëndësishme e politikave kulturore. Nëpërmjet kulturës, qytetarët marrin pjesë më aktive në jetën shoqërore dhe për këtë arsye orientimi i politikave kulturore drejt aksesit të publikut në produktet kulturore mbetet një nga prioritetet kryesore.

Njëlloj si në strategjitë e tjera, në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 nuk i kushtohet vëmendje e veçantë përfshirjes së të rinjve në çështjet e trashëgimisë kulturore ndërsa, Ministria e Kulturës përcaktohet si institucioni përgjegjës për artin dhe politikat kulturore që synojnë edhe rininë. Strategjia paraqet masa sipas të cilave pritet të rritet bashkëpunimi kulturor me Evropën duke marrë si shembull edhe fitimin e titullit të Kryeqytetit Evropian të Rinisë për Tiranën, por edhe duke nxitur rritjen e cilësisë së aktiviteteve pas-shkollore duke zhvilluar angazhimin në arte dhe zeje dhe aktivitetet sportive amatore.

Në kuadër të kësaj strategjie ka filluar edhe zbatimi i Programit kombëtar “Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore parauniversitare”<sup>17</sup>. Programi i quajtur ndryshe edhe si *Programet Jashtë Orarit Mësimor*, u zbatua gjatë vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar në 200 Shkolla të zgjedhura nga ZVAP-të dhe miratuara nga MAS, duke

<sup>17</sup> <https://arsimi.gov.al/programit-i-ri-jashte-orarit-mesimor-per-artet-dhe-zejet-ne-shkolla-nxenesit-rigjallerojne-traditat-dhe-kulturen-shqiptare/>



Funded by  
the European Union



angazhuar 644 punonjës arsimorë dhe 10,423 nxënës<sup>18</sup>, duke mbështetur këto shkolla me bazë materiale në ndihmë të veprimtarive krijuese.

Programi ka pasur si qëllim inkurajimin e mësimin të punimeve të artit dhe atyre artizanale përmes veprimtarive praktike, nxitjen e aftësive sipërmarrëse të nxënësve në perspektivën e ruajtjes dhe të promovimit të vlerave të komunitetit ku jetojnë, si dhe të trashëgimisë sonë kulturore në fushat: Pikturë; Vegla Muzikore; Bujqësia dhe Mjedisi; Zeje; Kor; Teatër; Sport-Mirëqenie; Fuqizim për Vetëmbrojtje; Teknologji.

Gjatë zhvillimit të këtij programi janë organizuar panairë dhe evente të ndryshme artistike në çdo shkollë, Zyrë Vendore Arsimore dhe Drejtori rajonale të arsimit parauniversitar (përfshirë qytetin e Durrësit).

Ky program nxit zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë, krijimtarinë, novacionin dhe marrjen përsipër të nismave, veprimtarive dhe projekteve që zhvillohen në shkolla në bashkëpunim dhe partneritet me prindërit, komunitetin dhe bizneset lokale.

Programi ka synuar për të zhvilluar më tej këto elementë:

- konceptin e edukimit për artet dhe zejet dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e plotë të potencialit të çdo nxënësi;
- veprimtaritë artistike dhe artizanale në shkolla, të tilla si veprimtaritë/klubet për degë të ndryshme të artit (pikturë, këngë, teatër, kërcim etj.);
- veprimtaritë/klubet për zeje të ndryshme (qëndisje, qeramikë, kulinari etj.);
- veprimtari në mjediset e shkollës apo në bashkëpunim me fermerët me fokus njohjen dhe kujdesin për produktet bujqësore tradicionale;
- konkurset brenda shkollës/ndërmjet shkollave, atelietë, panairët, vizitat në institucione të artit/site të trashëgimisë kulturore/qendra të punimeve artizanale, biseda me artistë/artizanë etj.;
- bashkëpunimin e shkollës me familjen dhe komunitetin, dhe ndërtimin e partneriteteve me individë, institucione, sipërmarrje, në nivel lokal dhe më gjerë.

## Një analizë e situatës dhe faktorëve që ndikojnë në trashëgiminë kulturore

Sjellja ndaj vlerave të trashëgimisë është një tregues shumë i rëndësishëm qytetërimi për një komb sepse tregon jo vetëm respekt për të kaluarën por edhe domosdoshmëri për evidencën objektive që siguron lidhjen e periudhave kohore në zinxhirin e gjurmueshmërisë historike në të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor. Vlerat e kulturës dhe të artit vlerësohen e ruhen vetëm atëherë kur e gjithë shoqëria sheh në to vlerat që duhet të mbrohen për brezat e ardhshëm.

<sup>18</sup> <https://www.expocity.al/event/aktiviteti-panairi-kombetar-i-shkollave-art-dhe-zeje-2023/>





Funded by  
the European Union



Qeveritë Shqiptare gjatë viteve të fundit e kanë përcaktuar industrinë e turizmit kulturor si një nga prioritetet e zhvillimit të vendit. Shqipëria është një destinacion turistik i sigurt e me vlerë të lartë që karakterizohet nga një larmi e atraksioneve natyrore e kulturore të klasit botëror me një sipërfaqe të vogël gjeografike dhe lehtësisht e mbërritshme nga tregjet turistike evropiane.

Shqipëria dhe pasuria e saj e trashëgimisë kulturore si dhe bukuria natyrore i mundësojnë vendit të pozicionohet në një vend të favorshëm për të mirëpritur turistë cilësorë nga Evropa dhe vende të tjera të botës. Por kultura duhet të jetë një pjesë e brendshme e politikës turistike. Turizmi cilësor kërkon një përvojë të ndryshme unike që një vend të jetë i veçantë (ofertë konkurruese) dhe të gjenerojë lloje të ndryshme shërbimesh dhe përvojash. Shqipëria duhet karakterizojë ofertën e saj kulturore duke nxjerrë në pah veçantinë e vendit dhe njerëzve të saj. Oferta kulturore e Shqipërisë dhe e qyteteve të saj është një kusht i rëndësishëm për të tërhequr investimet e huaja, turistë dhe talente.

Megjithatë, Shqipëria ende nuk e ka përcaktuar origjinalitetin e saj dhe çfarë përfaqëson.

Prioritet kryesor i është dhënë trashëgimisë kulturore, si burim i pashfrytëzuar për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, duke synuar rritjen e vëmendjes ndaj Shqipërisë dhe kthimin në një destinacion turistik të preferuar por që do të kërkonte investime të mëdha për restaurimin e monumenteve të kulturës, rritëzimin e qendrave historike e deri në ndërtimin e muzeve të reja sipas standardeve evropiane.

Mbrojtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore mbetet një nga drejtimit ku është përqendruar një pjesë e projekteve në fushën e kulturës. Disa nga projektet kryesore janë përqendruar në rigjallërimin e disa prej qendrave kryesore arkeologjike, si dhe në shpëtimin e vlerave muzeore të disa qyteteve. Gjatë viteve të fundit, theksi është vënë në krijimin e muzeve të reja, për të rritur numrin e destinacioneve kulturore, por edhe për të ruajtur më mirë kujtesën historike dhe kulturore të kombit.

Ndër më të vlerësuarit janë: Muzeu i Fotografisë “Marubi” në Shkodër”, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar në Korçë, Muzeu Arkeologjik në Durrës (i cili së fundmi ka marrë edhe statusin e një muzeu kombëtar) dhe Muzeu Kombëtar “Shtëpia e Gjetheve” në Tiranë.

Gjatë këtyre viteve të tranzicionit kulturor, Ministria e Kulturës, si institucioni kryesor i hartimit të politikave kulturore, ka qenë shpeshherë jokoherente në punën e saj. Për shkak të ndryshimeve të shpeshta të titullarëve dhe sidomos për shkak të mungesës së një administrate teknike, politikat e kësaj ministrie kanë qenë shpeshherë kontradiktore. Ministria vijon ende në procesin e ndryshimeve thelbësore në strukturime dhe emërtesa të Drejtorive të Përmbajtjes, duke zbehur gjithmonë e më tepër nocionet e strukturave që zhvillojnë politikat e fushave me specifika të veçanta.



Funded by  
the European Union



Njëherazi, bazuar në raportet e përvitshme të progresit të Komisionit Evropian<sup>19</sup>, ndryshimet e vazhdueshme të stafëve me përvojë, lëvizjet e shpeshta brenda strukturave për sa herë ndryshon organigrama e linjave të administratës shtetërore pa kritere të paravlerësuar të vendosjes së ekspertëve me vend e pa vend, nuk mundësoi krijimin e një administrate profesionale, të aftë për të ndërtuar politika të qëndrueshme zhvillimi për sektorin e kulturës.

Ndryshimet e shpeshta politike të administratës nga viti në vit, jo vetëm në këtë Ministri por edhe në të gjithë Administratën Publike Shqiptare (bazuar në raportet e përvitshme të progresit të lëshuara nga Komisioni Evropian) e kanë vështirësuar punën për krijimin e një grupi ekspertësh kulturorë në gjirin e kësaj ministrie ndër vite. Siç përmendet më lart, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, Ministria e Kulturës përcaktohet si institucioni përgjegjës për artin dhe politikën kulturore që synojnë edhe rininë ndaj puna e kësaj Ministrie është thelbësore për rritjen e pjesëmarrjes së rinisë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019-2025, gjithashtu vihet re një buxhet i pamjaftueshëm për arritjen e objektivave 7-vjeçare për të gjithë sektorët e zhvillimit kulturor në përgjithësi, duke marrë në konsideratë hendekun e lartë financiar prej rreth 5 milion EUR (nga përlllogaritja e shifrave të paraqitura në strategji) që ekziston midis nevojave financiare për arritjen e objektivave dhe fondeve që do të vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe financimi i huaj<sup>20</sup>.

Dinamika e sektorit kërkon të forcojë politikën dhe modelet e qeverisjes, ku të gjitha palët e interesuara të përfitojnë, duke ruajtur dhe promovuar gamën më të gjerë të mundshme të pasurive dhe shprehjeve kulturore. Trashëgimia kulturore, si motor zhvillimi dhe burim i qëndrueshëm ekonomie, gjenerohet si një kombinim i programeve urbane dhe qendrave historike si model suksesi i rritjes së trashëgimisë kulturore, që zgjon një interes të shtuar për popullsinë rezidente, turistët ndërkombëtarë, kritikët dhe vizitorët. Qytetet kryesore, të cilat kanë një traditë në art dhe kulturë, janë në pararojë edhe të tregut të artit dhe qyteti i Durrësit është një nga shembujt më të mirë në këtë drejtim.

Investimi në kulturë shpesh konsiderohet si dytësor për shkak të imazhit elitare të sektorit ose sepse shpenzimi në kulturë perceptohet si një kosto e pakthyeshme dhe jo një investim në të ardhmen që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social. Ndërsa burimet kulturore lidhen lehtësisht me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit, kjo përbën një qasje të ngushtë mbi ndikimin e investimeve kulturore. Tani ka prova të shumta që kultura kontribuon gjerësisht deri te zhvillimi ekonomik, punësimi, inovacioni, dija, sipërmarrja, arsimi, social dhe kohezioni.

<sup>19</sup> [https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Progress-Raport\\_versioni-perfundimtar\\_19.01.2022.pdf](https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Progress-Raport_versioni-perfundimtar_19.01.2022.pdf)

<sup>20</sup> <https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf>



Funded by  
the European Union



Strategjia Kombëtare për Kulturën (2019-2025) është dokumenti udhëzues për të gjitha politikat dhe legjislacionin në sektorin e IKK-ve. Prioritetet strategjike përfshijnë, ndër të tjera: përmirësimin dhe zgjerimin e tregut kulturor përmes legjislacionit për të mirën e krijuesve, krijimtarinë artistike e kulturore dhe trashëgiminë kulturore; mbështetjen për krijimtarinë dhe veprimtarinë krijuese të artistëve shqiptarë, duke rritur aktivitetet kulturore dhe përfshirjen e artistëve.

Mbështetur në një mekanizëm dhe projektim të arritjes së objektivave institucionale, institucioni përgjegjës për artin dhe kulturën (Ministria e Kulturës) nxjerr çdo vit thirrjen e hapur publike për projekt-aplikime nga subjekte, organizata apo shoqata kulturore. Në konsultim me ekspertë të vlerësimit të politikave dhe strategjive kulturore, janë vlerësuar fituese projekt-propozimet që shprehin: zhvillim të krijimtarisë kombëtare, ide novatore, hulumtojnë në projekte edukimi që nxisin leximin, aftësitë krijuese dhe zhvillojnë audiencën, sjellin zhvillim dhe gjallërim të skenës artistike e kulturore në Shqipëri, dëshmojnë respektimin e të drejtës së autorit, përkrahjen e të rinjve, duke filluar nga potenciali i tyre krijues e deri te punësimi. Ndër vite janë mbështetur projekte të artistëve të rinj, që propozojnë: proces kërkimor teatrore në zhvillimin skenik, festivale muzikore, edukim të artit e trashëgimisë përmes teknologjisë, duke besuar në rritjen e audiencave dhe kultivimin e publikut të ri në moshë. Janë zhvilluar dhe mbështetur platforma që shprehin qëndrueshmëri dhe vazhdimësinë realizim, shtrirje gjeografike dhe kohore dhe që kanë aftësi për të thithur fonde nga burime të tjera.

Ligji 27/2018 “Mbi trashëgiminë kulturore dhe muzetë” për herë të parë miratoi decentralizimin e administrimit dhe financimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe muzeve, liçencimin e vlerësuesve të pronave kulturore, liçencimin e tregtarëve të aseteve kulturore dhe akreditimin e muzeve. Gjatë zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës u regjistruan 203,294 objekte kulturore duke krijuar njëkohësisht edhe regjistrin e trashëgimisë kulturore materiale. Duke marrë në konsideratë numrin e monumenteve, Shqipëria renditet në vendin e dytë në pellgun e Mesdheut për nga dendësia e monumenteve të kulturës. Sipas statistikave<sup>21</sup>, vetëm 15 % e kësaj pasurie është pjesë e paketave turistike. Turizmi kulturor përbën vetëm në 1.6 % të GDP të vendit tonë. Këto shifra dëshmojnë për një mugesë të turizmit kulturor dhe përdorimin minimal të kapaciteteve që ka vendi ynë.

Pavarësisht bazës ligjore dhe strategjive në këtë drejtim, nuk ka një progres të dukshëm si pasojë e mungesës së njohurive por edhe burimeve njerëzore në institucionet përgjegjëse. Pavarësisht se Shqipëria e konsideron trashëgiminë kulturore si një nga shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm, praktika tregon që shumë monumente kulturore të regjistruara duhet të presin një kohë të gjatë për të hyrë në procesin e konservimit për shkak të burokracive komplekse, reagimit të vonuar të

<sup>21</sup> <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>



Funded by  
the European Union



autoriteteve dhe mungesës së financimit. Shumë monumente kulturore të zbuluara së fundmi ende nuk kanë hyrë në fazën e regjistrimit<sup>22</sup>.

Promovimi i trashëgimisë kulturore duket të jetë i pamjaftueshëm. Strategjitë inovative të marketingut dhe komunikimi digjital nuk po përdoren në nivelin e dëshiruar. Në të ardhmen, përdorimi i metodave bashkëkohore të komunikimit dixhital do të jetë parakusht për një fushatë efektive marketingu. Adoptimi i praktikave digjitale në fushën e trashëgimisë kulturore do të jetë thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor.

Gjithashtu, i pamjaftueshëm duket edhe bashkëpunimi i autoriteteve shtetërore dhe organizatave turistike pasi ende promovimi i trashëgimisë kulturore nuk është prioritet duke qënë se promovimi fokusohet kryesisht vetëm në peisazhin natyror të vendit tonë.

Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Turizmit, 37 % e udhëtimeve ndërkombëtare lidhen me një lloj turizmi kulturor. Sipas parashikimeve nga kjo organizatë, turizmi kulturor do të jetë një nga sektorët e turizmit që do të pësojë rritjen më të shpejtë. Sipas Rrjetit Evropian të Kulturës, trendi socio-kulturore dhe gjeografik që afekton rritjen e turizmit kulturor lidhet me plakjen e popullsisë botërore, rritjen e klasës së mesme, sofistikimin e klientëve, ndikimin e internetit dhe liberalizimin e transportit. Kërkesa për produkte dhe shërbime kulturore rritet ndjeshëm dita-ditës, si pasojë e rritjes së të ardhurave për frymë dhe rritjes së nevojave ekstra-ekonomike.

Përfshirja e rinisë në trashëgiminë kulturore lidhet ngushtë dhe ecën paralelisht me zhvillimin e politikës kulturore të një vendi.

Një nga sfidat kryesore në lidhje me politikën kulturore është modernizimi i institucioneve kulturore duke i përshtatur ato për të funksionuar në një ekonomi tregu, me forma të reja të konsumit kulturor, kufizime buxhetore, nevojën për ndërkombëtarizimin dhe rrjetëzimin, si dhe mobilizimin e burimeve alternative të financimit (investitorët në Shqipëri ende nuk janë mobilizuar për të mbështetur artin dhe kulturën). Oreksi për investime kulturore dhe konsum kulturor duhet të forcohet dhe rregullimi duhet të bëhet sa më tërheqës duke marrë parasysh investimet në sektorin kulturor nga investitorët privatë. Zhvillimi i shërbimeve turistike dhe nevoja për një ofertë koherente kulturore për të tërhequr vizitorë dhe investitorë është një mundësi për të zhvilluar një partneritet publik-privat.

Një sfidë tjetër lidhet me pozicionimin e shtetit dhe autoriteteve lokale në promovimin e shfaqjes së një ekonomie krijuese që rrjedh kryesisht nga edukimi dhe praktikat kulturo-artistike. Pak politikëbërës duket se janë të vetëdijshëm për potencialin e kulturës për zhvillim ekonomik dhe social. Është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për potencialin e kulturës dhe industrive krijuese në kontekstin lokal. Kjo do të ndihmojë në mobilizimin e burimeve të rëndësishme për

---

<sup>22</sup> <https://ina.media/?p=6092>



Funded by  
the European Union



të monitoruar zbatimin e politikës së trashëgimisë për shembull (mbrojtja e zonave kulturore), por edhe për të rritur financimin krahas buxhetit të shtetit.

Shumë shpesh kultura portretizohet ende si një stoli që ofron argëtim, një mjet për të lavdëruar arritjet kombëtare ose një aktivitet i rrezikshëm që kërcënon stabilitetin ose ideologjinë e një rendi politik. Specifikat e artit dhe kulturës janë më të thella pasi u mundëson njerëzve kolektivisht:

- Të shprehin historitë dhe kujtimet lokale duke e zgjatur dhe ndarë kështu ekzistencën e tyre në kontekstin universal.
- Të ofrojë reflektime kritike mbi realitetin dhe gjendjen njerëzore.
- Për të shprehur imagjinatën dhe për të na ndihmuar të eksplorojmë ndjenjën tonë të vetvetes duke promovuar individualitetin dhe zbulimin e njeriut dhe për të manifestuar bukurinë.

Iniciativat kulturore janë bërë një nga agjentët kryesorë të ndryshimit në shoqëri. Investimet kulturore dhe punonjësit e kulturës ndikojnë në atraktivitetin e vendeve (qyteteve), shpirtin dhe moralin e njerëzve, si dhe në fokusin e politikave qofshin kohezioni social, sipërmarrje, mirëqenie apo investime. Ky dokument postulon se arti dhe kultura nuk janë vetëm pjesë e një infrastrukture ekonomike si sektorët e tjerë, por janë edhe ato që i japin aromën, shijen dhe rëndësinë këtij ekosistemi.

Për të krijuar një politikë të fortë kulturore Shqipëria duhet;

- në nivel qytetar: të përdoret kultura si mjet për të krijuar dialog në komunitet, angazhim qytetar dhe pjesëmarrje; të rritet mirëkuptimi i ndërsjellë për të njohur forma të reja kulturore, konsumi dhe shkëmbimet shpesh të nxitura nga ndërveprimet sociale cilësore qofshin ato virtuale apo reale;
- në nivel arsimor: t'i kushtojë rëndësi aftësive artistike dhe krijuese; për të zhvilluar trashëgiminë kulturore dhe sensibilizojë të rinjtë për rëndësinë e saj; për të inkurajuar aksesin në ofertën kulturore, për të rritur punën krijuese e cila çon në rritjen e cilësisë së talenteve,
- në nivel diplomacie: të hiqet dorë nga diplomacia tradicionale që synon të promovojë gjatë një kokteili kulturën kombëtare të një vendi dhe në vend të saj të zhvillohen lidhje nëpërmjet rrjeteve dhe partneriteteve, të cilat do të mbështesin diversitetin kulturor dhe promovimin e talenteve dhe industrive lokale.

Është kusht vendimtar për Shqipërinë të përcaktojë dhe të përkufizojë parametrat e fushës kulturore, një mundësi dhe detyrim i vendit tonë për t'ju përafruar modeleve të industrive kreative dhe sipërmarrjeve të fushës mbi të cilat operojnë dhe performojnë potencialet krijuese dhe interpretuese të skenave më të njohura rajonale dhe evropiane. Prioritetet aktuale të strategjive të integritit e mbështesin integritimin e vendit gjithnjë e më tepër nëpërmjet harmonizimit dhe përafrimit të direktivave ligjore të BE si mekanizma të qëndrueshëm dhe



Funded by  
the European Union



efikas. Kjo do ndihmojë në ndërgjegjësimin e mëtejshëm të rinisë shqiptare për nevojën e zhvillimit të ndjenjës së përkatësisë në qytetërimin evropian, si një qytetërim i hapur ndaj botës, mbështetur në vlerat e përbashkëta të BE-së, që evidenton kontributin e kulturave dhe shprehjeve të diversiteteve kulturore në trashëgiminë e përbashkët.

## Rëndësia dhe roli i të rinjve në trashëgiminë kulturore

Në mënyrë që të kuptojmë rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore është e rëndësishme që fillimisht të shpjegojmë rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore kombëtare dhe çfarë ajo përfaqëson në shoqërinë e vendit tonë. Themeli kryesor i çdo vendi dhe çdo shoqërie është kultura e tij.

Trashëgimia kulturore është një mënyrë e të jetuarit që një komunitet e ka trashëguar nga brezat e mëparshëm dhe që ia kalon brezit pasardhës. Ajo i referohet vendeve kulturore, monumenteve, folklorit, aktiviteteve tradicionale, praktikave, gjuhëve, zakoneve, shprehjeve artistike, vlerave etj. që konsiderohen jetike për t'u ruajtur për brezat e ardhshëm. Trashëgimia kulturore u jep njerëzve një lidhje me disa vlera shoqërore, besime, fe dhe zakone. Gjithashtu i lejon ata të identifikohen me të tjerët me prejardhje të ngjashme. Trashëgimia kulturore u jep njerëzve një ndjenjë uniteti dhe përkatësie brenda një grupi dhe i lejon ata të kuptojnë më mirë gjeneratat e mëparshme dhe historinë nga vijnë.

Trashëgimia kulturore nënkupton një lidhje të përbashkët dhe përkatësinë tonë në një komunitet. Ajo përfaqëson historinë dhe identitetin tonë, lidhjen tonë me të kaluarën, me të tashmen dhe të ardhmen tonë. Në një epokë globalizimi, trashëgimia kulturore na ndihmon të kujtojmë diversitetin tonë kulturor dhe të zhvillojmë respekt të ndërsjellë dhe dialog të rinovuar midis kulturave të ndryshme.

Ka trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale. Një trashëgimi kulturore materiale nënkupton ndërtesa dhe vende historike, monumente dhe artefakte të cilat konsiderohen të denja për t'u ruajtur për të ardhmen. Ato përfshijnë objekte të rëndësishme për arkeologjinë, arkitekturën, shkencën ose teknologjinë e një kulture specifike. Objektet janë të rëndësishme për studimin e historisë njerëzore, sepse ato ofrojnë një bazë konkrete.

Trashëgimia kulturore jomateriale përfshin tradita ose shprehje të gjalla të trashëguara nga paraardhësit tanë dhe të transmetuara tek pasardhësit tanë, të tilla si traditat gojore, artet e performancës, praktikat shoqërore, ritualet, ngjarjet festive, njohuritë dhe praktikat në lidhje me natyrën, ceremonitë fetare, aftësitë për të prodhuar zanate tradicionale, muzikë, vallëzimi, letërsia, teatri, gjuhët dhe ushqimi.

Një trashëgimi e paprekshme është veçanërisht e vështirë për t'u mbrojtur pasi ajo vetëm përjetohet dhe nuk mund të mbahet në një vend të mbrojtur për t'u ruajtur. Më shumë se një





Funded by  
the European Union



individ apo një organizatë, ajo kërkon përpjekje nga një komunitet i tërë për ta mbrojtur atë. Kjo sepse një trashëgimi jomateriale na jep një ndjenjë identiteti.

Është e rëndësishme të kuptojmë se ajo që ne e shohim sot si trashëgiminë tonë kulturore është përzgjedhur me kujdes nga njerëzit që kanë jetuar dhe vazhjnë të jetojnë për të krijuar një ndjenjë të përbashkët identiteti; janë historitë që zgjedhim nga e kaluara jonë që thonë diçka për ne si popull. Trashëgimia kulturore luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Është ajo që na mban të lidhur me fenë, traditat dhe besimet tona. Është detyrë e shoqërisë sonë të ruajë trashëgiminë kulturore dhe edukimi i të rinjve për ta njohur, ruajtur dhe transmetuar atë është thelbësor për vazhdimin dhe forcimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe ruajtjen e identitetit kombëtar.

Këtu janë nëntë arsye thelbësore pse është e rëndësishme të ruhet trashëgimia jonë kulturore.

- Ajo përcjell mesazhe dhe vlera që i japin kuptim jetës së njerëzve.
- Ajo përfaqëson identitetin e një grupi shoqëror.
- Mund të sigurojë një ndjenjë uniteti dhe përkatësie brenda një grupi dhe na lejon të kuptojmë më mirë gjeneratat e mëparshme dhe historinë nga vijnë.
- Është burim i zhvillimit ekonomik.
- Ajo përfaqëson një mjet për të kuptuar diversitetin e njerëzve dhe zhvillimin e një politike për paqen dhe mirëkuptimin reciprok.
- Ajo ndikon fuqishëm në ndjenjën tonë të identitetit, besnikërisë, njohurive, besimeve, emocioneve dhe sjelljes.
- Ajo çon në ndërgjegjësimin më të gjerë për kompleksitetin tonë kulturor.
- Është një pasqyrim i teknologjisë, krijimtarisë dhe nivelit të zhvillimit intelektual të njerëzve.
- Është një burim unik dhe i pazëvendësueshëm i jetës dhe frymëzimit.

Ruajtja e trashëgimisë sonë kulturore nuk është thjesht një dëshirë. Mbi të gjitha ajo është një përgjegjësi e çdo populli. Çfarë kontributi mund të japim gjithsecili për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore? Fillimisht është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi për trashëgiminë kulturore në komunitetin tonë, veçanërisht tek të rinjtë, në mënyrë që të identifikohen mjete të ndryshme që mund të zhvillohen për ruajtjen e tyre.

Është e rëndësishme që rinia të përfshihet në të gjitha aspektet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, në mënyrë që të kuptojë dhe vlerësojë plotësisht vlerat e trashëgimisë dhe të zhvillojë një ndjenjë pronësie dhe identiteti.

Çelësi për ruajtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore është sensibilizimi i të rinjve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore, ndërgjegjësimi i tyre për ruajtjen e monumenteve dhe veprave të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht përfitimet e drejtpërdrejta të të rinjve të cilat lidhen ngushtë me punësimin e tyre dhe zhvillimin e turizmit kulturor. Kultura dhe pjesëmarrja e të



Funded by  
the European Union



rinjve në të mund të jetë një burim kyç i fuqizimit social dhe ekonomik. Turizmi nuk do të ekzistonte pa kulturë, sepse kultura është një nga motivet kryesore për lëvizjen e njerëzve dhe sepse çdo formë e turizmit do të provokojë një efekt kulturor si te vizitori ashtu edhe te pritësi.

Ndikimet direkte dhe indirekte të kulturës në zhvillimin lokal arrihen kryesisht përmes pjesëmarrjes kulturore. Pjesëmarrja kulturore përfshin mënyrat dhe format e ndryshme në të cilat individët mund të kenë akses ose të krijojnë të mira dhe përvoja kulturore. Pjesëmarrja kulturore mund të jetë aktive ose pasive. Në pjesëmarrjen aktive, individët kontribuojnë drejtpërdrejt dhe në mënyrë eksplicite në prodhimin e vetë përvojës kulturore si psh., duke luajtur një instrument muzikor, duke kënduar në një kor, duke vizatuar ose pikturuar, ose duke shkruar një tekst. Në pjesëmarrjen pasive, individët aksesojnë dhe shijojnë përvojat dhe përmbajtjet e krijuara nga dikush tjetër. Pjesëmarrja pasive përfshin dëgjimin e muzikës, leximin e një libri, ndjekjen e një ekspozite ose shfaqjeje teatrale etj.

Pjesëmarrja kulturore mund të ketë efekte të rëndësishme në shumë fusha të ndikimit social dhe ekonomik si psh.:

- Përfshirja sociale sidomos e grupeve të marginalizuara. – Aksesit në mundësitë kulturore është larg të qenit uniform dhe varet nga një sërë faktorësh si qasja lokale e institucioneve kulturore ose të ardhurat e një individi, arsimimi, përkatësia etnike, e kështu me radhë. Analiza e modeleve të pjesëmarrjes kulturore mund të ndihmojë në nxjerrjen në pah të mekanizmave të përjashtimit social dhe marginalizimit. Nga ana tjetër, promovimi i pjesëmarrjes kulturore mund të jetë një shtytës i fuqishëm i përfshirjes sociale dhe të ndihmojë në zbutjen e faktorëve që çojnë në marginalizimin social dhe ekonomik.
- Mirëqenia dhe shëndeti. – Bllokimet e lidhura me COVID-19 dhe masat e distancimit social kanë bërë të dukshme rëndësinë e artit dhe kulturës për mirëqenien mendore dhe fizike të njerëzve. Ky element, i cili tani bazohet në një grup të gjerë kërkimesh dhe eksperimentesh që po zgjerohen me shpejtësi, ofron një mundësi të re për të përfituar nga roli i kulturës në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve mendore dhe fizike gjatë gjithë jetëgjatësisë, dhe në përgjithësi në promovimin e qëllimit më të gjerë të zhvillimit të shëndetit dhe cilësisë së jetës.
- Sipërmarrja kulturore dhe krijuese. – Nivelet e larta të pjesëmarrjes kulturore mund të favorizojnë një mjedis social për sipërmarrjen kulturore dhe krijuese. Prandaj, pjesëmarrja është një mjet për të rritur prodhimin kulturor dhe rritjen e numrit të krijuesve dhe për rrejdhojë, krijimin e vendeve të punës.
- Trajtimi i sfidave shoqërore. – Në shumë qytete dhe rajone, pjesëmarrja kulturore dhe roli i sektorëve kulturorë dhe krijues po evoluojnë. Ato përdoren për të trajtuar sfidat shoqërore (p.sh. ndryshimi i klimës, integrimi i migrantëve) nga këndvështrime të reja, duke favorizuar elasticitetin, rritjen e aftësive ndërvepruese dhe ndryshimet prosociale të sjelljes.
- Mbështetja sociale për kulturën. – Nivelet e larta të pjesëmarrjes kulturore gjithashtu krijojnë mbështetje më të fortë për investimet publike dhe private dhe përmirësimin e politikave





Funded by  
the European Union



kulturore, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë financiare dhe sociale të sektorëve kulturorë dhe krijues.

Megjithatë për të zgjeruar përfshirjen e rinisë në pjesëmarrjen kulturore nevojiten ndërhyrje të mirë koordinuara të cilat duhet të jenë të afta të:

- Zgjerojnë fushëveprimin e qasjes së politikave ndaj pjesëmarrjes kulturore, për të zhvilluar pjesëmarrjen aty ku ka efekte të mundshme pozitive: shëndeti, ndryshimet shoqërore, kërkimi dhe inovacioni, mjedisi dhe klima, arsimiti, etj.
- Zhvillojnë një kuadër të përbashkët statistikor, duke përfshirë krahasimet ndërrajonale dhe ndërkombëtare, me të dhëna në kohë dhe sistematike për të matur dhe vlerësuar efektin e veprimeve të politikave në pjesëmarrjen kulturore.
- Krijojnë bashkëpunime të reja midis institucioneve kulturore dhe jokulturore, që mund të bashkëpunojnë në eksperimentimin dhe zbatimin e projekteve të kryqëzuara (p.sh. midis muzeve ose teatrove dhe spitaleve, midis orkestrave dhe institucioneve arsimore, ose midis hapësirave të pavarura të artit dhe planifikuesve urban, etj.).
- Angazhojnë qeveritë dhe institucionet rajonale, pasi shkalla rajonale është ideale për të eksperimentuar në një nivel kompleksiteti që është i menaxhueshëm për vlerësim dhe llogaridhënie dhe që është i balancuar midis shkallës së madhe kombëtare dhe shkallës së vogël lokale. Të mësuarit nga bashkëmoshatarët në të gjithë rajonet mund të krijojnë ndërgjegjësim për potencialin e promovimit të pjesëmarrjes kulturore për të mbështetur zhvillimin lokal të drejtuar nga kultura.

Për pjesëmarrjen kulturore përdoren disa përkufizime ndërkombëtare. UNESCO e identifikon pjesëmarrjen kulturore si një fazë të veçantë të një "cikli kulturor" hapat e të cilit janë: krijimi, prodhimi, shpërndarja, ekspozita/pritja/transmetimi dhe konsumi/pjesëmarrja. Bashkimi Evropian vë theks të veçantë në nocionin e aksesit në kulturë për grupe të ndryshme të popullsisë, që nënkupton një objektiv të politikës për heqjen e barrierave që pengojnë një akses të tillë.

Tradicionalisht, përkufizimet e pjesëmarrjes kulturore fokusohen në pjesëmarrjen si një formë e konsumit kulturor. Megjithëse kjo formë është qendrore, ka mundësi për të shkuar përtej dhe për të përfshirë aktivitete që lidhen me prodhimin e përmbajtjes. Sot, njerëzit kanë në dispozicion një grup të pafund mjetesh dhe aftësish që i mundësojnë praktikisht të gjithëve të krijojnë dhe të ndajnë përmbajtje kulturore dhe krijuese. Pjesëmarrja kulturore nuk duhet të identifikohet ekskluzivisht me ekspozimin pasiv në rolin e "audiencës".



Funded by  
the European Union



Përkufizimet më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjes kulturore mund të ndihmojnë politikatat të promovojnë forma të reja aktive me ndikim më të madh social dhe ekonomik. Siç edhe specifikuar më lart, pjesëmarrja kulturore në formën e saj më të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse përfshin si format pasive ashtu edhe ato aktive të pjesëmarrjes, si dhe aktivitetet e ashtuquajtura "artet dhe kulturën e lartë" dhe "artet dhe kulturën popullore". Kjo do të thotë gjithashtu se është e mundur të gjendet një dimension pjesëmarrjeje praktikisht në të gjitha fazat e ciklit kulturor të UNESCO-s: për shembull, pjesëmarrja aktive mund të lidhet drejtpërdrejt me krijimin dhe prodhimin kulturor. Sipas autorëve *Sacco, Ferilli dhe Tavano Blessi (Kultura dhe Zhvillimi Rajonal)* ekzistojnë tre qasje të ndryshme ndaj prodhimit kulturor dhe përfshijnë nocione të ndryshme të pjesëmarrjes: regjimi i patronazhit, regjimi i industrive kulturore dhe krijuese dhe regjimi i platformave të hapura.

Të tre regjimet e prodhimit kulturor (dhe format e tyre të pjesëmarrjes kulturore) përfshijnë shumë mënyra të mundshme në të cilat artet dhe kultura e çdo lloji mund të përjetohen në mënyrë kuptimplote nga njerëzit. Mund të ketë akses në treg ku duhet paguar një çmim ose tarifë. Mund të ketë akses të lirë, qoftë individual ose si pjesë e një grupi ose komuniteti. Mund të ketë akses në formën e shkëmbimit të ndërsjellë të përmbajtjes që u ofrohet të tjerëve në formate të caktuara dhe në kushte të caktuara, e kështu me radhë. Llojet e pjesëmarrjes kulturore janë domosdoshmërisht të hapura duke pasur parasysh shumëllojshmërinë dhe kompleksitetin e mundësive dhe evolucionin e tyre të shpejtë dhe të vazhdueshëm.

Pjesëmarrja në jetën kulturore është e nevojshme që të rinjtë të kuptojnë kulturën e tyre dhe të të tjerëve, e cila nga ana tjetër zgjeron horizontet e tyre dhe forcon aftësinë e tyre për të zgjidhur në mënyrë paqësore konfliktet dhe nxit respektin për kulturën e diversitetit. Çdo individ i përket një kulture të veçantë që shpreh besime, zakone dhe vlera të ndryshme. Trashëgimia kulturore është një aspekt themelor që i ndihmon individët të kuptojnë se sa mirë janë të lidhur me një kulturë të caktuar. Kur njerëzit kuptojnë kulturën e njerëzve të tjerë, ata i perceptojnë ata në një mënyrë të pranueshme dhe kjo redukton konfliktin midis individëve me prejardhje të ndryshme kulturore.

Kultura nuk është diçka që ne mund ta krijojmë në një ditë, javë apo muaj. Zhvillimi i kulturës në një shoqëri është një proces i gjatë. Shoqëria krijohet brenda një shekulli megjithatë duhen mijëra vjet për krijimin e kulturës së një vendi. Kuptimi i trashëgimisë sonë kulturore mund të na japë një ndjenjë më të mirë të identitetit tonë personal dhe të promovojë bashkëpunim më të mirë në komunitetin tonë. Ajo mund të luajë një rol thelbësor në shoqërinë tonë duke lidhur brezin e kaluar, të tashmen dhe të ardhshëm, një bazë për ndërtimin e një kombi dhe identiteti kombëtar të fortë.

Kultura ka fuqinë të transformojë shoqëri të tëra, të forcojë komunitetet lokale dhe të krijojë një ndjenjë identiteti dhe përkatësie për njerëzit e të gjitha moshave. Si një vektor për zhvillimin e të rinjve dhe angazhimin qytetar, kultura luan një rol thelbësor në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik për brezat e ardhshëm. Rinia mund të veprojë si një urë



Funded by  
the European Union



lidhëse midis kulturave dhe të shërbejë si agjent kryesor në promovimin e paqes dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

Të rinjtë që përfaqësojnë një segment të rëndësishëm të komunitetit:

- Mund të kontribuojë në zhvillimin lokal dhe prosperitet.
- Mund të jetë një urë lidhëse midis kulturave dhe midis traditës dhe modernitetit.
- Të kenë interes, energji dhe pasion për të trajtuar çështje dhe shqetësime, si menaxhimi i trashëgimisë, turizmi i qëndrueshëm, zhvillimi lokal dhe përfshirja e komunitetit.
- Të kenë prirje për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për të rrjetëzuar dhe për të kapërcyer kufijtë gjeografikë.
- Janë në gjendje të veprojnë si agjentë të fuqishëm të ndryshimeve pozitive sociale që do të sjellin mirëqenie më të madhe ekonomike dhe sociale në perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm për brezat që do të vijnë.

Në të njëjtën kohë, të rinjtë janë veçanërisht të prekur nga sfidat e zhvillimit në të gjitha nivelet, të cilët shpesh ballafaqohen me nivele disproporcionale të larta të papunësisë, akses të pamjaftueshëm në arsim dhe trajnim profesional, intolerancë dhe përjashtim, ndër të tjera. Kjo është edhe më imponuese në qytetet ku rritja e urbanizimit i ka theksuar më shumë këto sfida për të rinjtë.

Investimi në burimet kulturore lokale, duke përfshirë trashëgiminë materiale dhe jomateriale, duke përfshirë njohuritë dhe aftësitë tradicionale, si dhe muzikën, kërcimin, teatrin dhe festivalet, mund të zhvillojë ekonomi të qëndrueshme krijuese, të hapë mundësi për të rinjtë dhe të ndihmojë në forcimin e identitetit dhe kohezionit social. Prandaj, promovimi i kreativitetit për dhe mes të rinjve dhe shfrytëzimi i potencialit dhe energjisë krijuese të të rinjve duhet të jetë një prioritet në gjetjen e zgjidhjeve kreative për sfidat e sotme.

Si një nga burimet e pakta natyrore të pashtershme në botë, kreativiteti është një burim i një potenciali të konsiderueshëm në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik për njerëzit e të gjitha moshave. Industritë krijuese mund të shërbejnë si një trampolinë për ide të reja dhe inovacione, të cilat mund të hapin mundësi të reja për punësim dhe mësim, duke promovuar në të njëjtën kohë mirëqenien dhe vetëvlerësimin dhe fuqizimin e komuniteteve të tëra. Të rinjtë po angazhohen gjithnjë e më shumë në propozimin e zgjidhjeve kreative për sfidat lokale. Kjo energji krijuese duhet të shfrytëzohet në mënyrë që të maksimizohet ndikimi pozitiv që mund të ketë në shoqëri.

Industrializimi dhe rritja ekonomike shkojnë paralelisht me rritjen dramatike të popullsisë dhe ndryshimet sociale. Këto ndryshojnë stilet e jetës dhe krijojnë presione të reja mbi përdorimin e tokës dhe burimet. Ndërtesat e trashëgimisë shpesh shkatërrohen në zonat urbane bazuar në argumentin se toka duhet të përdoret për përdorime ekonomike më produktive ose duhet t'i shërbejë nevojave më të rëndësishme sociale.



Funded by  
the European Union



Megjithatë, këto argumente zakonisht injorojnë faktin e thjeshtë se trashëgimia është një pasuri ekonomike që, e menaxhuar siç duhet, mund të kontribuojë në mënyrë të vazhdueshme në rritjen e të ardhurave në nivel kombëtar. Një pjesë e rëndësishme tërheqjes për miliona turistë që dynden çdo vit në Londër, Paris, Venecia, etj. dhe qytete të tjera të njohura evropiane, qëndron në eksplorimin e ndërtesave historike, vendeve dhe faktorëve të tjerë që janë pjesë e trashëgimisë kulturore të këtyre qyteteve. Turizmi kulturor ofron punësim, rigjallëron vendet e vjetra dhe gjeneron mundësi të reja në tregti dhe industrinë e shërbimeve dhe industrinë kulturore në përgjithësi, nga të cilat përfitues direkt mund të jenë të rinjtë. Statistikisht, industrinë kulturore dhe krijuese punësojnë më shumë njerëz të moshës 15 deri në 29 vjeç, se çdo sektor tjetër.

Trashëgimia jonë është një trashëgimi nga e kaluara jonë. Është diçka me të cilën jetojmë sot dhe, me shpresë, diçka që mund t'ua përcjellim brezave të ardhshëm. Në çdo vend, trashëgimia kulturore është njëkohësisht një kujtim i jetës dhe historisë dhe gjithashtu një burim i pazëvendësueshëm krijimtarië dhe frymëzimi. Trashëgimia jonë kulturore, si ADN-ja jonë, përcakton se kush jemi, duke na dhënë identitetin dhe vlerat që do të udhëheqin jetën tonë në një botë në ndryshim.

Megjithatë, pavarësisht nga rëndësia e saj, nuk ka asnjë garanci që trashëgimia do të mbijetojë dhe do t'i kalojë brezit të ardhshëm. Kjo ka qenë e vërtetë gjatë historisë dhe është edhe më e vërtetë sot. Por ndoshta problemi më i madh nga të gjithë është thjesht neglizhenca njerëzore, dështimi për të vepruar kur trashëgimia nga e kaluara është në rrezik. Vetëm rregulloret dhe ligjet nuk mund të ruajnë kulturën. Njerëzit janë ato që duhet të njohin, vlerësojnë dhe ruajnë trashëgiminë e tyre që ajo të mbijetojë. Mënyra më e mirë për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore është ta ndajmë atë me të tjerët. Është përgjegjësia jonë të mbajmë të paprekur historinë për brezin e ardhshëm, në mënyrë që ata të kenë të njëjtat mundësi për të mësuar për të kaluarën dhe rrënjët e tyre si ne.

Për ta ilustruar, sjellim në vëmendje shembullin e Romës së lashtë. Në vitin 425 pas Krishtit, kur qyteti i Romës ishte tashmë mbi 1000 vjet i vjetër, perandori Majorian ishte aq i shqetësuar për prishjen e ndërtesave historike, sa që dekretoi një urdhër që çdo zyrtar publik që autorizonte një punë të tillë duhet të gjobitej fshikullohej ose amputuar!<sup>23</sup> Pavarësisht dekretit, gjatë shekujve që pasuan, pjesa më e madhe e qytetit antik u shkatërrua vazhdimisht. Shkatërrimi i vërtetë nuk u shkaktua nga barbarët pushtues, por nga vetë romakët, të cilët shkatërruan gradualisht ndërtesat e vjetra për të ripërdorur blloqet e mermerit dhe prishën skulptura klasike për të bërë gëlqere për ndërtuesit e piktorët. Në kohën kur njerëzit mësuar të vlerësonin trashëgiminë e Romës së Lashtë, mbi 90% e saj ishte zhdukur.

Aktualisht të rinjtë në mbarë botën janë gjithnjë e më shumë të përfshirë në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë, duke pranuar se trashëgimia nuk i përket vetëm së kaluarës, por është edhe pjesë e identitetit të tyre. Iniciativat botërore/rajonale, strategjitë, mbështetjet me

---

<sup>23</sup> Novella Maioriani 4



Funded by  
the European Union



donacione apo programe të dedikuara nga ana e aktorëve globalë siç janë, Kombet e Bashkuara, UNESCO apo Bashkimi Evropian (veçanërisht i prekshëm për vendin tonë), në lidhje me trashëgiminë dhe përfshirjen e të rinjve, tregojnë qartë se kultura është një shtytës i domosdoshëm dhe mundësues i zhvillimit të qëndrueshëm.

Më poshtë listohen shkurtimisht disa nga iniciativat më kryesore në nivel global/rajon/kombëtar të cilat në një mënyrë ose një tjetër përfshijnë drejtpërdrejt vendin tonë dhe ofrojnë mundësi reale për rritjen e përfshirjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore:

- *Strategjia e Kombeve të bashkuara Rinia 2030* (Youth 2030), lançuar në vitin 2018 – synon të rrisë ndjeshëm kapacitetin e OKB-së për të angazhuar të rinjtë dhe për të marrë parasysh pikëpamjet, njohuritë dhe idetë e tyre drejt realizimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, ku një aspekt i rëndësishëm është edhe kultura dhe trashëgimia kulturore. Në zbatimin e kësaj strategjie merr pjesë aktive edhe vendi ynë ndërsa ajo është hartuar në kuadër të Programit Botëror të Veprimit për Rininë (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në 1995), i cili ofron një kornizë politikash dhe udhëzime praktike për veprim kombëtar dhe mbështetje ndërkombëtare për të përmirësuar situatën e të rinjve në mbarë botën.
- *Programi Edukativ i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s*, përpiqet t'u japë të rinjve mundësinë për të mësuar dhe zhvilluar duke marrë njohuri për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Botërore. Forca lëvizëse e programit është përfshirja e të rinjve si një segment kryesor i komunitetit, duke marrë parasysh dimensionet kulturore, duke i inkurajuar ata të bëhen mendimtarë dhe aktorë të zhvillimit. Programi ka gjeneruar shumë projekte dhe aktivitete të ndryshme si, kurse trajnimi për zhvillimin e aftësive dhe seminare edukative. Ndërsa, *Programi Vullnetar i Trashëgimisë Botërore* dhe instrumenti i tij kryesor, *Trashëgimia Botërore në Duart e Reja* (WHYH), ka arritur të paktën 1 milion studentë të rinj, përfshirë vendin tonë.
- *Strategjia e BE për të rinjtë 2019-2027*<sup>24</sup> - është korniza për bashkëpunimin e politikave për të rinjtë në BE. Ajo mbështet pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike dhe kulturore dhe synon që të sigurojë që të gjithë të rinjtë të marrin pjesë në shoqëri. Për një zbatim sa më të suksesshëm të strategjisë, BE ka aktivizuar iniciativën - Dialogu Rinor i BE-së (në të cilën bën pjesë edhe vendi ynë), i cili është një mekanizëm dialogu ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve që zhvillohet në kuadrin e Strategjisë së BE-së për Rininë.
- *Programi Creative Europe 2021-2027*<sup>25</sup>, ka një buxhet prej 2.44 miliardë euro, krahasuar me 1.47 miliardë euro të programit të mëparshëm (2014-2020). Ky Program investon në veprime që përforcojnë diversitetin kulturor dhe u përgjigjen nevojave dhe sfidave të sektorëve kulturorë dhe krijues. Objektivat kryesore të programit janë:

<sup>24</sup> [https://youth.europa.eu/strategy\\_en](https://youth.europa.eu/strategy_en)

<sup>25</sup> <https://culture.ec.europa.eu/news/creative-europe-2021-2027-programme-launch>



Funded by  
the European Union



UNOPS



- të ruajnë, zhvillojnë dhe promovojnë diversitetin dhe trashëgiminë kulturore dhe gjuhësore evropiane;
- rritja e konkurrencës dhe potencialit ekonomik të sektorëve kulturorë dhe krijues.

Risite e programit do të kontribuojnë në rimëkëmbjen e këtyre sektorëve, duke përforcuar edhe angazhimin e rinisë në çështjet e trashëgimisë kulturore.

*EU4Culture*<sup>26</sup> - Projekti EU4Culture financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë. Ai fokusohet në rinovimin dhe rivitalizimin e vendeve kryesore të trashëgimisë kulturore të dëmtuara nga tërmeti dhe përfaqëson një nga programet më të mëdha të trashëgimisë kulturore të financuar nga Bashkimi Evropian me një buxhet total prej 40 milionë euro. Udhëhequr nga parimi "Ndërtimi më i mirë", EU4Culture fokusohet në rinovimin e vendeve kryesore të trashëgimisë kulturore në përputhje me Kornizën e OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë. Paralelisht, projekti synon të rrisë potencialin turistik të Shqipërisë, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në rimëkëmbjen socio-ekonomike lokale dhe rajonale. Për këtë qëllim, fokus i veçantë i kushtohet teknologjive inovative, duke përfshirë tregimin dixhital dhe krijimin e produkteve multimediale të dizajnuara për të qenë të aksesueshme për të gjithë. Në të njëjtën kohë, projekti po mbështet sipërmarrjen lokale, zejtarinë dhe iniciativat kulturore që zhvillohen rreth zonave të përzgjedhura përmes shpërndarjes së granteve, duke ofruar një nxitje të drejtpërdrejtë për ekonominë lokale.

*-EUSAIR*<sup>27</sup> (*Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jon, në të cilën bën pjesë edhe vendi ynë*) në objektivin e tij specifik - oferta e diversifikuar e turizmit (produkte dhe shërbime) nën shtyllën 4 - Turizmi i Qëndrueshëm – identifikon rëndësinë e industrive krijuese dhe/ose kulturore, si dhe sipërmarrjen kulturore, në mënyrë që të forcojë avantazhin turistik e socio-ekonomik që rajoni ka ndërtuar tashmë.

Më 16 maj 2022, përfaqësuesit e qeverive të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Greqisë, Italisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, San Marinos, Serbisë, Sllovenisë dhe Komisionit Evropian, u takuan në Tiranë, në kuadër të Forumit të 7-të të EUSAIR ku u miratua e ashtuquajtura Deklarata e Tiranës “Shkëmbimi kulturor BE-RINI”. Gjatë këtij forumi, rinia u shpall prioritet i Presidencës së EUSAIR (mbajtur në atë kohë nga vendi ynë) ndërsa Tirana u shpall Kryeqyteti Rinor Evropian për 2022. Rinia u konfirmua si faktor kryesor i bashkëpunimit rajonal, pajtimit dhe ndërtimit të paqes ndërsa u evidentua nevoja e forcimit të rolit të rinisë dhe në veçanti përfshirja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet këshillit rinor të EUSAIR si një nga instrumentet kryesore të përfaqësimit.

<sup>26</sup> <https://eu4culture.al/>

<sup>27</sup> <https://www.adriatic-ionic.eu/>




## Rezultatet e pyetësorit


Me qëllim analizimin e situatës së njohurive dhe përfshirjes së të rinjve në fushën e trashëgimisë kulturore u hartua një pyetësor me 12 pyetje i cili u shpërnda në disa nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Durrësit. Pyetësori u plotësua online nga rreth 100 të rinj. Pyetjet për të cilat u kërkua mendimi i të anketuarve ishin me alternativa dhe të hapura (pyetja 5 dhe pyetja 12); këto të fundit synonin të evidentonin më thellësisht njohuritë dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për lidhjen midis trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit socio-ekonomik dhe synonin të mblidhnin propozime nga vetë nxënësit për rritjen e angazhimit të tyre në fushën e trashëgimisë kulturore.

Analiza e këtij pyetësori do të shërbejë jo vetëm për testimin e përgjithshëm të njohurive të nxënësve por do të shërbejë edhe si dokument mbi bazën e të cilit do të lëshohen disa nga rekomandimet kryesore për rritjen e angazhimit të të rinjve në qytetin e Durrësit për çështjet e trashëgimisë kulturore, duke marrë në konsideratë njëkohësisht edhe propozimet e vetë nxënësve, bazuar në përgjigjet e tyre.

Më poshtë paraqitet secila nga pyetjet e drejtuara në pyetësor e shoqëruar me analizën përkatëse bazuar në të dhënat sasiore dhe cilësore, sipas përgjigjeve të nxënësve.

### 1- Si do ta përkufizonit trashëgiminë kulturore?






1. Si do ta përkufizonit trashëgiminë kulturore?


Nga të rinjtë e anketuar, 63,4% kanë përzgjedhur përgjigjen më të saktë e cila përfshin në trashëgiminë kulturore traditat dhe zakonet kulturore, artefaktet dhe monumentet historike si dhe njohuritë dhe praktikatat tradicionale. Duket se nxënësit e kanë relativisht të qartë që pjesë e trashëgimisë kulturore janë si pasuria kulturore materiale po ashtu dhe ajo jo-materiale.

26,8% e të rinjve klasifikojnë si trashëgimi kulturore vetëm traditat dhe zakonet, ndërsa për 9,8% të tyre, trashëgimia kulturore nënkupton vetëm artefaktet dhe monumentet e kulturës, duke e lidhur trashëgiminë kulturore me monumentet fizike që janë dhe objektet e prekshme.

## 2- Cilat nga sa vijon mund të konsiderohen si shembuj të trashëgimisë kulturore jomateriale?









2. Cila nga sa vijon mund të konsiderohet si shembuj të trashëgimisë kulturore jomateriale?

Edhe në këtë rast, 61% e të rinjve të anketuar kanë përzgjedhur alternativën e saktë duke klasifikuar si trashëgimi kulturore jo-materiale, vallet popullore dhe muzikën tradicionale. Edhe në këtë rast, gjejmë konfirmim konkluzionet e nxjerra nga pyetja e parë ku vetëm 60% e të rinjve të anketuar kanë një koncept të qartë mbi trashëgiminë kulturore dhe mbi ndarjen e saj në dy kategori të mëdha siç janë, trashëgimia kulturore materiale dhe ajo jo-materiale.

### 3- Njihni ndonjë qytet/lokacion në Shqipëri i cili është bërë pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore.




### 3. Njihni ndonje qytet/lokacion ne Shqiperi i cili eshte bere pjese e Listes se Tashegimise Boterore?




73,2 % e të rinjve të anketuar përgjigjen se njohin të paktën një qytet ose objekt në Shqipëri i cili bën pjesë në trashëgiminë Botërore.



Rreth 30 % e të rinjve kanë përmendur Butrintin si lokacionin që ato njohin në Shqipëri dhe që është pjesë e Trashëgimisë Botërore, ndërsa me rreth 20% është përmendur Berati dhe me rreth 18% Gjirokastra.



#### 4- Cila është rëndësia e trashëgimisë kulturore?



- a) Ai pasqyron identitetin dhe pamjen e një komuniteti.
- b) Kontribuoni në lidhje me turizmin dhe zhvillimin ekonomik.
- c) Nxiti dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor.
- d) Të gjitha sa më sipër





52,5% e të rinjve të anketuar e shohin rëndësinë e trashëgimisë kulturore në disa dimensione duke përfshirë identitetin e një komuniteti të caktuar, aspektin ekonomik të lidhur me turizmin si dhe ndërthurjen kulturore me komunitete të tjera.

Gjithsesi, 35% të të anektuarve e lidhin rëndësinë e trashëgimisë kulturore vetëm me rëndësinë për identifikimin kulturor të një komuniteti të caktuar ndërsa vetëm 10% të të anketuarve e

shohin rëndësinë e trashëgimisë kulturore ekskluzivisht të lidhur me zhvillimin ekonomik nëpërmjet nxitjes së turizmit kulturor.

**5- Mendoni që ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mund të shërbejë si një instrument i rëndësishëm për zhvillim socio-ekonomik të një vendi?**



80% e të rinjve të anketuar janë të vetëdijshëm mbi rolin që ka trashëgimia kulturore në zhvillimin social dhe mbi të gjitha ekonomik të një zone të caktuar. Kjo kryesisht për faktin se të rinjtë e lidhin trashëgiminë kulturore dhe me turizmin.


Pyetjes, për të përshkruar shkurtimisht lidhjen midis trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit socio-ekonomik, të rinjtë i janë përgjigjur si më poshtë (*citohet sipas përgjigjeve të nxënësve*):

- Atraksionet turistike të cilat mund të tërheqin më shumë turistë;




- Duke rritur ndjenjën ndaj trashëgimisë edhe qasja ndaj turisteve do të jetë më e madhe, kjo do të çojë në rritjen ekonomike të qytetit, më shumë vende pune për personat që merren me turizmin;
- Është mjet që një shtet e përdor për ta kthyer atë në një vlerë ekonomike;
- Kultura e një vendi është një arsye plus pse zgjidhet të vizitohet nga turistë nga vendet më të ndryshme të botës, duke ndikuar kështu edhe zhvillimin socio-ekonomik;
- Duke ditur të shkuarën tonë dhe mënyrën si kemi jetuar punuar apo kemi kryer aktivitet qofte edhe të përditshëm na ndihmon të zhvillohemi nga ana sociale duke u njohur nga të tjerët dhe duke treguar lashtësinë tonë. Por gjithashtu është një aset me kontribuimin në ekonominë e vendit me anë të turizmit;
- Trashëgimia kulturore mund të jetë afeksion turistik, për rrjedhojë nxit zhvillimin socio-ekonomik;
- Promovimi i trashëgimisë bën të mundur njohjen e vlerave kulturore të vendit tonë edhe nga vendet e tjera;
- Trashëgimia kulturore sjell me vete dhe turizmin dhe si rrjedhojë dhe zhvillimin social – ekonomik;
- Një trashëgimi kulturore e pasur mund të ndikojë në turizmin e një vendi dhe të rrisë të ardhurat nga turizmi. Një trashëgimi kulturore e pasur mund gjithashtu të ndikojë në identitetin kombëtar dhe të forcojë ndjenjën e bashkimit në një vend;
- Trashëgimia kulturore mund të ndikojë në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi në mënyra të ndryshme, duke përfshirë përdorimin e burimeve natyrore, zhvillimin e turizmit dhe industrive kreative dhe ndërtimin e identitetit kombëtar;
- Atraksion nga turizmi;
- Nëse vizitohen nga turistë të vendit dhe të huaj, sigurisht ndikon në zhvillimin social-ekonomik;
- Ndikon në turizëm, turizmi në ekonomi;
- Frekuentimi i turisteve të vendeve të trashëgimisë kulturore;
- Të mirat më të medha që na vijnë prej ruajtjes së traditës janë sociale. Është thelbësore që për të njohur veten, njeriut i duhet të njohë rrënjët e tij. Manifestimi i kulturës sonë Shqiptare, i identitetit tonë Evropian na hap rrugë bashkimi, vëllazërie. Si shumica e gjërave dhe kultura mund të kapitalizohet sot por mendoj që më së shumti duhet të fokusohemi në përfitimet shpirtërore prej trashëgimisë sonë kulturore;
- Promovon turizmin;
- Trashëgimia kulturore është pasqyrë e identitetit kombëtar. Zhvillimi socio-ekonomik vjen si rrjedhojë e turizmit dhe bashkëveprimit kulturor, të cilat janë kurioze të njohin kulturën dhe trashëgiminë kulturore por njëkohësisht kontribuojnë në vendin tonë me anë të sektorit të turizmit;
- Kulinariteti dhe zhvillimi i turizmit.

## 6- Si mund të ruhet Trashëgimia Kulturore?




- a) Konservimi dhe restaurimi i vendeve dhe objekteve historike
- b) Dokumentimi dhe regjistrimi i traditave dhe praktikave gojore
- c) Angazhimi i komuniteteve lokale në iniciativat për ruajtjen e trashëgimisë
- d) Të gjitha sa më sipër




Nga anketimi i kryer, rezultojnë se 58.5% e të rinjve mendojnë që trashëgimia kulturore e një vendi mund të ruhet duke, ndërthurur konservimin dhe restaurimin e objekteve historike, duke regjistruar dhe dokumentuar traditat dhe folklorin si dhe duke angazhuar komunitetet lokale në iniciativat për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Ky rezultat tregon se një pjesë e madhe e të rinjve, gati 70% e të anketuarve, e shohin dhe angazhimin komunitar si një mjet për ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore. Ky është një element i rëndësishëm pasi tregon që ato janë të ndërgjegjshëm mbi rolin e tyre dhe të komunitetit ku ato jetojnë në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të vendit të tyre.

## 7- Cili është roli i UNESCO-s në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.



- a) Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimi për trashëgiminë kulturore
- b) Përcaktimi i vendeve të trashëgimisë botërore me vlerë të jashtëzakonshme universale
- c) Lehtësimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale
- d) Të gjitha sa më sipër




Përsa i përket rolit të UNESCO-s në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, të rinjtë e anketuar janë përgjigjur si më poshtë:

- 27.5 % mendojnë se roli i UNESCO ka të bëjë me nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore;
- 17.5% e të rinjëve mendojnë se roli i UNESCO ka të bëjë vetëm me përcaktimin e vendeve të trashëgimisë botërore me vlerë të jashtëzakonshme universale;
- 10% mendojnë se roli i UNESCO ka të bëjë me lehtësimin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale;
- 45% e tyre mendojnë se roli i UNESCO i përfshin të gjitha alternativat e vendosura në këtë pyetje.

Alternativa më e saktë që të rinjtë mund të përzgjidhnin ishte pikërisht alternativa e fundit e cila pohon se roli dhe detyrat UNESCO-s përfshijnë nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe

ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore, identifikimin e vendeve dhe objekteve të cilat për shkak të vlerave të tyre janë pjesë e trashëgimisë botërore si dhe të mbështesë shtetet në ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale. Nga rezultatet e pyetësorit dilet në përfundimin që vetëm 45% e të anketuarve kanë përzgjedhur përgjigjen më të saktë duke vënë në dukje nevojën për një informim më të thellë të të rinjve mbi entitetet e ndryshme që janë përgjegjëse për forcimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

### 8- Si mund të kontribuojnë të rinjtë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore?



Alternativat e dhëna si përgjigje për këtë pyetje ishin vendosur qëllimisht disi të ndërlikuara.



63.4% e të rinjve janë përgjigjur që rinia mund të kontribuojë në promovimin e trashëgimisë kulturore duke u aktivizuar në mënyrë vullnetare në projekte, duke marrë pjesë në ngjarje festive



dhe kulturore si dhe duke u angazhuar në kërkimin dhe dokumentimin e traditave kulturore. Normalisht kjo nuk ishte alternativa më e saktë nga ato të vendosura, sidomos për faktin se jo të gjithë të rinjtë i kanë aftësitë e nevojshme për kërkimin dhe dokumentimin e traditave kulturore. Rezultati i kësaj pyetje tregon se të rinjtë nuk janë shumë të informuar mbi rolin e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.


Alternativa që mund të quhet më e saktë është angazhimi vullnetar në projekte për promovimin e trashëgimisë kulturore, dhe këtë përgjigje e kanë dhënë vetëm 17.1% e të anketuarve.

9- **A keni vizituar personalisht ndonjë vend të trashëgimisë kulturore apo keni marrë pjesë në aktivitete të lidhura me trashëgiminë kulturore?**




70.7 % e të rinjve të përfshirë në studim kanë pohuar se kanë vizituar personalisht një vend të trashëgimisë kulturore ose kanë marrë pjesë në një event të trashëgimisë kulturore. Ndërkohë që 29.3 % e tyre nuk kanë vizituar ose kanë marrë pjesë në ndonjë event të trashëgimisë kulturore.

**10- A besoni se edukimi i trashëgimisë kulturore duhet të integrohet në kurrikulat shkollore?**





- a) Po, është e rëndësishme për të nxitur ndërgjegjësimin dhe vlerësimin kulturor.
- b) Jo, nuk është relevant apo i nevojshëm për arsimin modern.
- c) I pasigurt ose nuk kam mendim.



Vetëm më pak se rreth 5% e të rinjve të anketuar janë shprehur kundër integritit në kurrikulat shkollore të edukimit mbi trashëgimisë kulturore. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 85.4% e të anketuarve, janë shprehur pozitivisht për zhvillimin e orëve të mësimin të dedikuara specifikisht për trashëgiminë kulturore. Ndërsa, 9.8% e nxënësve nuk kishin një opinion të qartë mbi këtë pyetje.

## 11- A keni marrë ndonjëherë pjesë në aktivitete vullnetarizmi për Trashëgiminë Kulturore?



Nga të rinjtë e anketuar, vetëm 22.5% e tyre pohojnë se kanë marrë pjesë rregullisht në aktivitete vullnetarizmi të lidhura me trashëgiminë kulturore. Rreth 50% e tyre kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetarizmi në mënyrë sporadike, ndërsa 27.5% e të anketuarve nuk kanë marrë pjesë ndonjëherë në aktivitete të trashëgimisë kulturore si vullnetarë.

## **12- Cfarë burimesh apo nismash shtesë do të dëshironit të shihni për të rritur njohuritë dhe angazhimin e të rinjve në çështjet e trashëgimit kulturor?**

Të rinjve të anketuar u është kërkuar që të japin mendimin dhe propozimet e tyre se çfarë nismash mund të ndërmerren për të rritur angazhimin e tyre në çështjet e trashëgimit kulturor.

Disa nga alternativat e përmendura prej tyre janë (*citohet sipas përgjigjeve të nxënësve*):

- Më shumë aktivitete që përfshijnë të rinjtë;
- Trajnime specifike për kthimin e trashëgimit kulturor dhe vemendjen e të rinjve ndaj objekteve kulturore dhe jo vetëm;
- Punë dhe vullnet për të pasur sa më shumë interes për të vizituar vende për të kontribuar për to;
- Organizimi i këtyre nismave argëtuese duke zgjedhur mënyra të ndryshme të zhvillimit të këtyre aktiviteteve si psh. quiz pasi sjell më tepër interesin e të rinjve për të marrë pjesë e për t'u njohur më tepër me trashëgiminë kulturore të vendit;
- Të shtohet në kurrikulat shkollore;
- Udhëzues digjitalë;
- Më shumë projekte ku të tregojnë për trashëgiminë kulturore të vendit tonë ku të rinjtë të kenë mundësi të marrin pjesë, sepse duke pasur mundësinë të marrin pjesë në projektet që do zhvilloheshin rregullisht apo shpesh për trashëgiminë kulturore do mësonin dikë më shumë çdo ditë dhe do ndërjegjësoheshin;
- Nisma nga shkolla për aktivitete në lidhje me trashëgiminë kulturore;
- Festivale për kërcimet tradicionale të vendeve;
- Aktiviteve apo guida turistike ku të rinjtë të njohin dhe vleresojnë trashëgiminë kulturore;
- Shtimin ekspeditave në vende të ndryshme;
- Organizimi i aktiviteteve ku të rinjtë mund të kontribuojnë, ose projekt ide nga të rinjtë të cilat mund të jenë inovatore, study tour-e në disa lokacione/qytete pjesë të trashëgimit kulturor të planifikuara për çdo vit shkollor. Angazhimi dhe marrja e nismave të tilla do të rrisë interesin e rinjve, që aktualisht nuk është i madh;
- Një ndër arsyt kryesore të degradimit dhe humbjes së vlerave të trashëgimit kulturor është mungesa e informacioneve mbi rëndësinë e trashëgimit kulturor dhe si rrjedhojë mos angazhimi i qytetarëve në ruajtjen e saj. Të rinjtë përfaqësojnë të ardhmen, kështu që ndërjegjësimi i tyre mbi rëndësinë dhe vlerat e trashëgimit kulturor rrit përgjegjësinë e tyre për ruajtjen e saj, si dhe përkujdesjen që të vazhdojë të ruhet edhe në të ardhmen dhe t'i përcillet gjeneratave që do të vijnë pas tyre;
- Krijimi i nismave dhe aktiviteteve inovatore e argëtuese për të rinjtë për t'u shtuar atyre kureshtjen për t'u njohur me trashëgiminë kulturore por edhe për ti nxitur për të marrë pjesë në këto aktivitete;



Funded by  
the European Union



- Të rinjtë duhet të angazhohen më shumë, të marrin pjesë në aktivitete ose debatete që zhvillohen për trashëgiminë kulturore;
- Krijimi i një mjedisi që promovon trashëgiminë kulturore;
- Shkollat duhet ti angazhojnë të rinjtë sa më shumë në aktivitete të trashëgimisë kulturore.

## Konkluzione dhe rekomandime

Angazhimi i të rinjve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore konsiderohet tashmë si një domosdoshmëri nga organizatat ndërkombëtare, institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe më gjerë. Bazuar në analizën e politikave dhe strategjive ekzistuese në nivel kombëtar e lokal, analizën e iniciativave të institucioneve përgjegjëse, analizën e situatës së ndërgjegjësimit dhe angazhimit të të rinjve në fushën e trashëgimisë kulturore (bazuar kjo edhe në rezultatet e pyetësorit), arrihet në përfundimet e mëposhtme:

- Pavarësisht se në Shqipëri, aktualisht, janë në zbatim 3 strategji kryesore (Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 dhe Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026) në asnjë prej tyre nuk adresohet me ndërhyrje konkrete, çështja e rritjes së përfshirjes së të rinjve në fushën e trashëgimisë kulturore. Asnjë nga këto strategji nuk ka në fokus të saj përfshirjen e të rinjve, madje as nuk evidentohet rëndësia e kësaj çështje por parashikohen disa masa të cekta dhe të izoluar të cilat nuk mund të sjellin rezultatet e dëshiruara. Pavarësisht, disa iniciativave pozitive të ndërmarra nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit vitet e fundit, mungesa e masave/aktiviteteve konkrete apo vizionit në secilën strategji, bëhet pengesë për ndërmarrjen e iniciativave të konsoliduara nga ana e institucioneve përgjegjëse.
- Edhe pse strategjitë/ligjet dhe institucionet përgjegjëse e konsiderojnë përfshirjen e të rinjve dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore si shumë të rëndësishme, niveli i ndërgjegjësimit, pjesëmarrjes dhe përfshirjes së komunitetit dhe veçanërisht të rinjve në proceset përkatëse është i ulët.
- Me gjithë mangësitë që karakterizojnë kryesisht iniciativat e institucioneve dhe të pushtetit kombëtar e vendor për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, nuk po bëhen përpjekje që ato të shoqërohen me studime nga ana e institucioneve përgjegjëse për sa i përket rolit që mund të luajnë të rinjtë (për tu shoqëruar më pas me masa/ndërhyrje konkrete).
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore në vend dhe përfshirja e të rinjve në këtë sektor, has një sërë problemesh që lidhen me praktikatat e menaxhimit dhe mungesën e investimeve të financimit nga qeveria.
- Duke marrë në konsideratë financimin e ulët nga ana e buxhetit të shtetit në këtë fushë, rezulton se edhe numri i projekteve që financohen nga Bashkimi Evropian (si donatori më i



Funded by  
the European Union



madh në vendin tonë) apo donatorët e tjerë me fokus në të rinjtë dhe trashëgiminë kulturore është mjaft i kufizuar.<sup>28</sup>

- Vihet re një mosbesim i përgjithshëm nga të gjithë aktorët në lidhje me vlerën dhe përfitimet e investimit në kulturë/trashëgimi kulturore e cila nuk konsiderohet si gjenerues i zhvillimit ekonomik dhe social në të njëjtën masë si investimet në sektorët e tjerë.
- Konstatohet se organizimi i të gjitha aktiviteteve që lidhen me të rinjtë dhe trashëgiminë kulturore iniciohen nga institucionet qendrore politikbërëse dhe nuk janë identifikuar iniciativa të cilat janë ndërmarrë në mënyrë të pavarur nga ana e institucioneve lokale të qytetit të Durrësit (përfshirë këtu Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar apo edhe vetë shkollat).
- Vihet re një numër mjaft i ulët i aktiviteteve shkollore që synojnë të rrisin përfshirjen e të rinjve në fushën e trashëgimisë kulturore.
- Pavarësisht se trashëgimia kulturore është pjesë e kurrikulave në disa prej lëndëve që zhvillohen në arsimin parauniversitar, përmbajtja e tyre fokusohet në kulturën si formë e ruajtjes së identitetit kombëtar dhe informacioni nuk synon të evidentojë potencialin e kulturës në vetvete dhe përfitimet direkte apo indirekte tek të rinjtë.
- Vihet re se, dijet e të rinjve në fushën e trashëgimisë kulturore janë të kufizuara por edhe një ndërgjegjësim i ulët i tyre mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore por paralelisht edhe një interes i tyre për tu bërë pjesë e aktiviteteve të cilat lidhen me trashëgiminë kulturore.
- Ndërgjegjësim i ulët për rëndësinë e trashëgimisë kulturore vihet re edhe te mësuesit e arsimit parauniversitar duke qënë se mungojnë trajnimet specifike për këtë çështje.

Duke qënë se ky udhërrëfyes ka në fokus të tij qytetin e Durrësit, rekomandimet që propozohen për rritjen e përfshirjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore janë të një karakteri kryesisht lokal dhe ato i adresohen veçanërisht shkollave të qytetit të cilat janë të përfshira drejtpërdrejt në edukimin e të rinjve por edhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Durrësit (Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore), përfshirë Bashkinë dhe Prefekturën Durrës. Në këtë proces nuk duhet të mungojë edhe përfshirja e institucioneve fetare të cilat mund të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm për arsye se kanë në administrimin e tyre objekte fetare të cilat janë një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të qytetit të Durrësit.

<sup>28</sup> [https://www.eeas.europa.eu/eeas/projects\\_en?s=214&f%5B0%5D=project\\_site%3AAlbania](https://www.eeas.europa.eu/eeas/projects_en?s=214&f%5B0%5D=project_site%3AAlbania)

<https://integrimi-ne-be.punetijashtme.gov.al/wp-content/uploads/2021/08/Annual-Implementing-report-IPA-2020.pdf>

<https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%3%ABtare-p%3%ABr-Kultur%3%ABn-2019-2025.pdf>



Funded by  
the European Union



Duke marrë në konsideratë gjetjet gjatë hartimit të këtij udhërrëfyese rekomandohen disa nga masat e mëposhtme.

Duke marrë parasysh që shumë prej të rinjve kanë shprehur dëshirën për tu angazhuar në aktivitete që lidhen me kulturën/trashëgiminë kulturore, rekomandohet që institucionet lokale të qytetit të Durrësit të përdorin këtë gatishmëri për të organizuar aktivitete, ngjarje apo festime që lidhen me kulturën/turizmin të cilat, kërkojnë burime që mund të vihen në dispozicion përmes angazhimit të të rinjve. Interesi i të rinjve për vullnetarizëm mund të shfrytëzohet psh. nga ana e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe pushtetit vendor, duke qënë se të rinjtë vullnetarë mund të kontribuojnë nëpërmjet punës në terren, në mirëmbajtjen e objekteve arkeologjike, monumenteve dhe muzeve, duke shoqëruar turistët dhe vizitorët vendas në udhëtimet e tyre drejt atraksioneve turistike, etj.

Për më tepër, dëshira e shumicës së të rinjve të anketuar për t'u angazhuar jo thjesht vullnetarisht, por edhe për të kontribuar përmes formave të tjera të pjesëmarrjes mbetet e lartë ndaj nga ana e pushtetit vendor rekomandohet që të zhvillohen aktivitete sa më masive me pjesëmarrjen e të rinjve të cilat synojnë promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore/kulturës së qytetit dhe angazhimin e të rinjve në jetën kulturore/artistike (promovimi i talenteve), organizimi i ngjarjeve të mëdha si festivale, karnavale, gara, etj.

Edukimi i trashëgimisë, në kurrikulën e arsimit parauniversitar, i fuqizon të rinjtë të mbledhin njohuri dhe vetëdije për vlerat kulturore dhe të rrënjosin brenda vetes rëndësinë e ruajtjes dhe transmetimit të trashëgimisë dhe kulturës tek brezat e ardhshëm. Në sistemin arsimor në Shqipëri, edukimi i trashëgimisë përfshihet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, por mbi bazën e konsultimeve me literaturën, lënda e trashëgimisë kulturore studiohet kryesisht në disiplinat e gjeografisë dhe historisë. Edhe në këto disiplina mësimi i njohurive të trashëgimisë është i kufizuar. Në këtë pikë, sugjerohet rishikimi i kurrikulës dhe zgjerimi i njohurive në këtë disiplinë duke vënë theksin në përfitimet e të rinjve dhe zhvillimin ekonomik që lidhet me ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Në të njëjtën kohë, konsiderohet e nevojshme përfshirja e mësuesve në trajnime dhe seminare për rritjen e tyre profesionale në drejtim të edukimit të trashëgimisë kulturore.

Shkollat mund të luajnë një rol kyç në rritjen e angazhimit të të rinjve ndaj në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore mund të zhvillojnë programe të posaçme trajnimi, qoftë edhe në formën e kurrikulave jashtëshkollore të cilat mund të rrisin ndërgjegjësimin, angazhimin dhe zhvillimin e aftësive të të rinjve për të marrë pjesë aktive në trashëgiminë kulturore (me fokus në teknikat e ruajtjes së trashëgimisë, dokumentimit kulturor, organizimin e eventeve, interpretimin, etj).

Për më tepër, shkollat në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Ministrinë e Arsimit (si politibërës në këtë sektor) dhe institucionet vendore mund të:





Funded by  
the European Union



- Organizojnë vizita të rregullta në objektet e trashëgimisë kulturore, përfshirë këtu objektet e kultit të institucionve fetare;
- Krijojnë programe mentorimi dhe logjistikën e nevojshme që lidhin profesionistë me përvojë me individë të rinj të interesuar për trashëgiminë kulturore për të ndihmuar në shndërrimin e ideve inovatore të nxënësve në realitet;
- Përmirësojnë aftësitë dixhitale të nxënësve nëpërmjet ofrimit të trajnimeve dhe burimeve për përdorimin e teknologjive dixhitale për kërkime, dokumentacion dhe promovim të trashëgimisë kulturore;
- Ngrejnë rrjete dhe platforma bashkëpunimi midis të rinjve;
- Krijimin e një database të aksesueshme për publikun me të dhëna konkrete mbi ecurinë dhe zbatimin e planeve dhe strategjive lokale, përfshirë këtu dhe çështjet e lidhura me trashëgiminë kulturore.
- Inkurajojnë dhe mbështesin të rinjtë në zhvillimin e projekteve dhe iniciativave të tyre në lidhje me trashëgiminë kulturore për të ndihmuar në shndërrimin e ideve të tyre në realitet;
- Krijojnë partneritete midis organizatave rinore, institucioneve kulturore, institucioneve arsimore dhe komuniteteve lokale;
- Promovojnë dialogun nëpërmjet brezave për inkurajimin e shkëmbimit të ideve, tregimeve dhe aftësive midis brezave të ndryshëm, ku të rinjtë mund të mësojnë nga të moshuarit dhe mbajtësit e njohurive tradicionale;

Duke marrë në konsideratë se, disa nga rekomandimet e mësipërme kërkojnë edhe sigurimin e fondeve financiare, rekomandohet që përveç fondeve që mund të përfitohen nga Ministria e Kulturës për këtë qëllim, shkollat dhe institucionet vendore të shfrytëzojnë donacionet e Bashkimit Evropian i cili është edhe donatori më i madh i vendit tonë. Të gjitha programet që financon BE (të përmendura në këtë dokument) kanë si prioritet kulturën/trashëgiminë kulturore dhe shkollat apo institucionet e tjera vendore janë plotësisht subjekte të lejueshme për të paraqitur projekt-propozime të cilat kanë në fokus rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në trashëgiminë kulturore. Sidomos, Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar që përfiton Shqipëria janë një mundësi shumë e mire që shkollat apo institucionet vendore të qytetit të Durrësit të përfitojnë donacione dhe të shkëmbejnë eksperiencë të vyera nëpërmjet projekteve të përbashkëta me partnerët e tjerë rajonalë dhe evropianë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e të rinjve.

Mjaft e rëndësishme është edhe zhvillimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjëse nga institucionet përgjegjëse politikbërëse për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe pjesëmarrjen e të rinjve duke përdorur kanale të thjeshta komunikimi, si mediat sociale apo faqet e internetit. Gjithashtu, angazhimi i mediave lokale për mbulimin mediatik të nismave të udhëhequra nga të rinjtë dhe tregimeve të suksesit por edhe angazhimi i personazheve publike për këtë qëllim, konsiderohet mjaft efikas për të përforcuar mesazhin e angazhimit të të



Funded by  
the European Union



rinjve në trashëgiminë kulturore. Gjithashtu, duhet një angazhim më i lartë i insitucioneve vendore për të pasqyruar dhe promovuar vlerat e objekteve kulturore të zonës së Durrësit.

Duke ndjekur këtë udhërrëfyes, shkollat dhe insitucionet vendore të qytetit të Durrësit mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm që fuqizon të rinjtë të marrin pjesë aktive në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore, duke siguruar vitalitetin e saj për brezat e ardhshëm.

## Referenca të tjera

- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 - <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029-1.pdf>
- Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 - <https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.Pdf>
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 - <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>
- Këshilli i Ministrave, 2018. Ligji Për Trashëgiminë Kul-turore dhe Muzetë. (low For Cultural Heritage and Mu-seums) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Online: [kultura.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Ligji.nr27-\\_dt.17-05-2018.pdf](https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Ligji.nr27-_dt.17-05-2018.pdf)
- MESR [Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë], 2017. Kurrikula me Zgjedhje, Lënda Gjeografi. MESR.Tiranë:2–46
- MESR [Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë], 2019. Kurrikula Bazuar në Kompetenca, Lënda Gjeografi, Klasa eIX. MESR.Tiranë: 2–79
- MTKR [Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Rinisë], 2006. Strategjia Kombëtare e Rinisë (2007–2013). MTKR.Tiranë:3–86
- Peci D., Nikolli X., 2017. Vështrim mbi politikat rinore ne Shqipëri. Analizë në nivel qendror dhe lokal 2015–2019, Tiranë